



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional
“Teknik në Operacione Bisnesi, Marketing dhe Shitje”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ermira Qosja
2. Prof. Dr. Klodiana Gorica

Qershor 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 568 datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Pasi të akreditohet
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 Kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/3
18	Numri i studentëve (2018-2022):	21 student
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Barleti" është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 571, datë. 12.08.2005, fillimisht si Shkolla e Lartë Universitare jo Publike" Universiteti Marin Barleti". Në datë 24.10.2019, nëpërmjet Urdhërit të MASR Nr. 511, institucioni u riorganizua, për të vijuar më tej me riorganizimin Urdhër Nr. 213, të MASR, datë 03.07.2020 që kishte të bënte me kalimin e statusit në Universitetin "Barleti".

Ky Universitet ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 9, date 07.04.2017, me kohëzgjatje 6 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.12.2023 dhe u riakreditua me VBA Nr. 60, datë 16.12.2021 me emërtimin e ri Universiteti Barleti, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me vlefshmëri deri më 15.12.2026.

Universiteti "Barleti", është i organizuar në 3 fakultete:

1. Fakulteti të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë,
2. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Diplomë Profesionale "Teknik Operacionesh Biznesi, Marketingu dhe Shitje" licencuar me Urdhër të MASR Nr. 568, date 12.09.2018 dhe që filloi veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019. Ky program studimi është regjistruar si program profesional, Niveli 5 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke u përfshirë në fushën "Shkenca Sociale" ku bëjnë pjesë edhe biznesi, marketing e shitja. Programi ofrohet në gjuhën shqipe, forma e studimit me kohë të plotë, dy vite normale akademike dhe 120 ECTS. Në fund të studimeve, studenti pajiset me diplomë profesionale në programin "Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje".

Programi i studimit diplomë profesionale "Teknik në Operacioni Biznesi, Marketing dhe Shitje" synon të krijojë dije dhe aftësi në fushën e operacioneve të biznesit, marketingut dhe shitjes, duke i orientuar studentët drejt nevojave të tregut të punës dhe vetëpunësimit e sipërmarrjes. Në hapjen e këtij programi do të kishte qenë efikase zhvillimi i një kërkimi në treg për të kuptuar nevojat reale.

Programi në strukturën e tij reflekton disa problematika: mungesën e kategorisë A të lëndëve bazë; ekzistencën e disa lëndëve të cilat kanë vështirësi të zhvillohen pa disa lëndë bazë dhe në këtë nivel studimi; përsëritje në tematikat e disa silabuseve dhe një përjasje ndaj praktikave e cila duhet të qartësohet për mënyrën si realizohet.

Dokumenti 56. VKM Nr 568, datë; 12.09.2018, Urdhër për hapjen e programit me karakter profesional TOBMSH

Dokumenti 7. Rregullore e Programit të Studimit


Dokumenti 58: VKM 571, 12.08.2005 Dhënie leje për hapje institucioni

Dokumenti 59: Urdhër MASR Nr. 511, datë, 24.20.2019; Riorganizim institucional

Dokumenti 60: Urdhër MADR Nr. 213, datë 03.07.2020; Riorganizimi për ndryshimin e statusit

Dokumenti 14: Plani mësimor

Dokumenti 19.I: Silabuse



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Dr. Klodiana Gorica. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Diplomë Profesionale në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë pranë Universitetit “Barleti”, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në Universitetin “Barleti”, u realizua në datën 17 Mars, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në Universitetin “Baleti”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, Stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Dekanin e Studentëve, Zyrën e Pranimin dhe Rekrutimin si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Diplomë Profesionale në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Më datë 05/05/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/39 Prot., datë 05/05/2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 30/05/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 679 Prot., datë 26.05.2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Strategjia e zhvillimit institucional 2020- 2030 konfirmon dhe thekson të rëndësishëm në politikat e këtij IAL formimi multidiplinor dhe aftësitë soft. Aty theksohet se UniBa do të jetë një universitet aplikativ, inovator dhe krijuës. (Dokumenti 3. <i>Strategjia e zhvillimit institucional 2020 2030, fq 9</i>). Misioni dhe vizioni i shprehur në këtë strategji tregojnë qartë qasjen me zhvillimin profesional ndërkohë që ky program studimi është hapur në vitin akademik 2018- 2019, dhe strategjia e zhvillimit institucional i përket periudhës 2020- 2030.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i Universitetit Marlin Barleti 2020, dhe Rregullorja e Institucionit e miratuar me vendim Senatit Akademik nr 60, datë 13/04/2021, përcaktojnë në objektivat, parimet dhe shtyllat e aktiviteteve kryesore të UniBa përcaktojnë drejtimit prioritar akademike dhe demonstrojnë qartë se programet e studimit profesional hartohen në zbatim të tyre, në funksion të pasjes së një universiteti novativ dhe sipërmarrës. Për këtë statuti përcakton njësitë të cilat kujdesen për mbarëvajtjen e programeve. Përveç fakulteteve dhe departamenteve përkatëse ka krijuar dhe njësitë që kontrollojnë cilësinë apo matin performancë. <i>Dokumenti 5. Rregullore e Universitetit Marlin Barleti, neni 12, 13, 14, 15.</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Departamenti Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës. Sipas RVB thuhet se bazuar në Strategjinë e zhvillimit institucional 2020 2023, faqe 10, zhvillohet në përputhje ky program studimi. Po në këtë strategji thuhet se janë zhvilluar analiza të herëpashershme të tregut të punës që konfirmojnë dhe mbështesin këtë strategji për kohën e aplikimit të saj (pas 2020).
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Nuk mund të konsiderohen si bazë të qënësishme për të hapur një program studimi vetëm konsultat apo tryezat e rrumbullakta dhe bisedat me specialistë të marketingut apo manaxhimit, apo edhe manaxherë të bizneseve të mëdha në vend nuk janë të mjaftueshme dhe nuk mund të ndërtohen programe cilësore dhe konkurruese në këtë mënyrë. Për të ndërtuar një program studimi është e nevojshme ndërtimi i një strategjie të mirëfilltë që përfshin edhe pasjen e një studimi tregu të mirëfilltë për këtë synim, i cili sigurisht bazohet edhe në diskutimet apo focus grupet, pra në kërkimin cilësor. Pra, metodologjia e hapjes së një program studimi duhet të bazohet në të dy komponentët: kërkim sasior (studim i mirëfilltë tregu) dhe kërkim cilësor

	<p>(diskutime me specialistë etj). Kjo metodologji përbën kriter të rëndësishëm sepse mbi bazën e kësaj do të mund të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtohen kurrikula cilësore, pra me përfshirjen e atyre moduleve/lëndëve që vërtet kërkon tregu; 2. Kompetenca dhe aftësi që transmetohen përmes njohurive që merren nga program i studimit. Pra mbi këtë bazë ndërtohen më tej edhe syllabuset e duhura për vendin tonë, pra për ato aftësi që kërkon tregu; 3. Ndërtohen bazat për të patur një background plot njohuri dhe koncepte sa teorike po aq edhe praktike, por të bazuara në nevojat e biznesit shqiptar dhe jo të adaptuara nga jashtë; 4. Rrjedhimisht edhe zhvillimet e praktikave do të mundësohen në ato institucione me të cilat është bashkë-kompozuar program i studimit, platforma dhe përfshirë modulet brenda tij.
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Si pjesë e tabelave përmbledhëse në dokumentin C Aneks, është vënë në dispozicion tabela 21 që reflekton cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Sipas kësaj tabele, për të tre vitet që ofrohet ky program studimi (2018 – 2019, 2019 – 2020, 2020- 2021) rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Numri total i të regjistruarve është 18 (përkatesisht në vitet e shpërndarë: 3, 11, 4) b. Numri i të diplomuarve total është 4 studentë, dhe ato të diplomuar në përputhje me diplomën është vetëm 2, pra gati 10% e atyre që janë regjistruar në këtë program studimi punësohen sipas tregut që kanë bërë programin e studimit. <p>Ky përbën një tregues se marrëveshjet e bashkëpunimit janë jo efektive. Përsa kohë që nr në hyrje është relativisht mjaft i ulët krahasuar me aplikimet (400), por edhe më i ulët është numri i të diplomuarve dhe veçanërisht i atyre të punësuar në tregun aktual të punës që orinton program në fjalë, kjo tregon se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ose nuk është ndërtuar mirë program, dhe njohuritë e marra nuk përafrojnë me tregun 2. Ose nuk janë eficientë marrëveshjet e bashkëpunimit. <p><i>(Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse Cilësia në Hyrje dhe Dalje e Studentëve, tab 21.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ndërtimi i këtij program studimi nuk është kryer mbi bazën e një studimi të mirëfilltë të tregut, studim i cili do të përcaktonte aftësitë dhe njohuritë kryesore që kërkojnë programe të tilla të formimit profesional. Kjo konstatohet dhe dakortësohet edhe në takimet në institucione me dekanin apo drejtues të njësive bazë. Si rezultat i mungesës së studimit të tregut edhe përmbajtja e programit (modulet/lëndët) nuk ofron atë çka kërkon tregu, duke rezultuar në një rrjedhojë të rezultateve që nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • numri i ulët i të punësuarve sipas profilit të formimit (vetëm 10% është punësuar në profil), • apo qoftë edhe një punësim i ulët në total I të diplomuarve, • sikurse edhe nga numri i ulët i regjistrimeve në hyrje në raport me

	<p>aplikimet.</p> <p>Si rezultat i mospasjes së një informacioni se sa dhe si tregu ynë kërkon specialitë/teknik të shitjes dhe marketingut, edhe kërkesat dhe nevojat e punëdhënësve nuk janë realizuar, apo zhvillimet e pritshme të sektorit nuk janë plotësuar.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018- 2019, me synimin për të patur një qasje me profesionale ndaj tregut. Ashtu sikurse u konstatua edhe nga vizita në terren, brenda institucionit ka patur një mbështetje positive për të hapur këtë program studimi dhe për t'a bërë atë të suksesshëm. Për këtë janë angazhuar jo vetëm departamenti i ekonomisë, financës, sipërmarrjes si përgjegjës për këtë program studimi por edhe njësitë e tjera qoftë përgjegjëse për cilësinë, karrierën apo etikën.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni në nivele makro ka vendosur shumë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. E reflektuar edhe në dokumentat kryesore të UniBA, si statutë, rregullorja apo strategjia e zhvillimit institucional reflektohet nevoja dhe qasja ndaj biznesit për të synuar dhe arritur orinetimin drejt inovacionit.</p> <p>Në tab 34, Marrëveshje Bashkëpunimi aktive, tregohen disa marrëveshje bashkëpunimi të vendosura midis institucionit dhe institucioneve të tjera jo akademike brenda vendit, si Hotel Adriatik, Kastrati, Sky Tour, etj. <i>Këto marrëveshje janë vendosur në muajin Korrik 2021 dhe janë aktive për pas kësaj periudhe, ndërkohe që ky program studimi ka filluar në 2018- 2019 e më tej për 2 vite të tjera akademike.</i></p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe efektiviteti i tyre bëhen të dukshme në rradhë të parë në procesin e realizimit të praktikave mësimore. Normalisht ky program studimi si program profesional përmban shume kredite dhe orë të praktikës mësimore, të shpërndara si brenda lëndëve/ moduleve ashtu edhe më vete. Kjo do të thotë së institucionet bashkëpunuese luajnë një rol kyç në përftimin e njohurive praktike, gjë e cila në fakt nuk ndodh. E dokumentuar edhe në Listën e studentëve që kanë zhvilluar praktikë në vitin akademik 2019- 2020, 2020- 2021, por edhe e dakortësuar nga diskutimet me grupet e interes nga vizita në institucion, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët e këtij program studimi kanë kryer praktikën vetëm në bankën e nivelit të dyte Credins dhe Concept Marketing

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Albania;</p> <ul style="list-style-type: none"> Po kështu, për lëndë të veçanta elementët e praktikës janë kryer po në bankën e nivelit të dytë Credins. <p>Ndërkohë që, e konsideruar shumë e rëndësishme në formimin e studentëve dhe transmetimin efektiv të njohurive, praktika duhet të zhvillohet në ato institucione ku vërtet kanë nevojë për njohuri profesionale të shitjeve, operacioneve të biznesit apo veprimeve të marketingut, si psh: supermarketet, Spar, TEG, QTU, Megatek, etj. Një studim i mirëfilltë i tregut do të nxirrte dhe rezultonte nevojën se vërtet ka nevojë për specialist të tillë, por jo për banka të nivelit të dytë por për biznese ku ndjehet mungesa e aftësimeve të tilla profesionale si qendrat tregtare, supermarketet, etj. Bankat e nivelit të dytë nuk mund të përbëjnë institucione për të kryer praktikën për këtë program studimi, pasi ato janë të orientuar për të thithur student që kanë mbaruar apo janë në proces të studimeve bachelor apo master dhe jo të programeve të formimit profesional. Megjithatë institucioni mundohet të realizojë studime koherente dhe periodike të përfitimit nga marrëveshjet, por për këtë program studimi sugjerohet që në të ardhmen raportet e tilla të jenë sa më shumë edhe në terma sasiore të përfitimit.</p> <p><i>Dokumenti 32 Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Dokumenti 34 Marrëveshje Bashkëpunimi Aktive</i> <i>Dokumenti 35/A. Lista e studentëve që kanë zhvilluar praktikën në vitin akademik 2019 2020, 2020 2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Bazuar në tabelën nr 35, lista e studentëve që kanë zhvilluar praktikën në këtë program mësimor, vihet re se 2019- 2020 ku edhe është nr më i madh i të studentëve (11), të gjithë e kanë zhvilluar praktikën në bankë të nivelit të dytë. Pyetja që u shtrua edhe në vizitën në institucion dhe u diskutua është: këto specialistë që po përgatisni i keni të targetuar për bankat e nivelit të dytë? Studimi i tregut ju ka treguar se bankave të nivelit të dytë i duhen student me diplomë profesionale? Apo nuk janë eficientë marrëveshjet e bashkëpunimit? A nuk është më mirë që të synohen bizneset dhe të ketë një qasje më aktive me to si në krijimin e kurrikulave ashtu edhe në intershipet dhe punësimet e mëtejshme?</p> <p>Të gjitha këto paqartësi vijnë jo nga fakti se tregu ynë nuk ka nevojë për këtë profil të studentëve me karakter profesional. Përkundrazi, nevoja është e madhe dhe universiteti mund të luajë një rol thelbësor në këtë furnizim të tregut me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale. Por është qasja e gabuar ndaj mënyrës se si është kompozuar ky program, mungesa e studimit të tregut, mungesa e lëndëve/moduleve praktike, etj të cilat në fund reflektohen dhe me kryerjen e praktikës jo në institucionet e duhura duke i bërë jo eficientë marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Rrjedhmisht reflektohet se vetëm 10% e të diplomuarve janë punësuar sipas profilit të formimit profesional, ndërkohë që po ashtu vihet re një numër shumë i ulët i të diplomuarve. Vetëm 4 studentë janë diplomuar në 3 vite studimi që ka zgjatur ky program studimi. Pra nga 18 studentë që kanë kryer studimet në 3 vite akademike, vetëm 4 janë</p>

	<p>diplomuar dhe vetëm 2 prej tyre janë punësuar në tregun në përputhje me diplomën. Ndërkohë që është për t'u theksuar se institucioni i ben perpjekjet e veta për të punësuar studentët, por një orientim më i mirë përmes, dhe drejt tregut do t'a përkufizonte këtë iniciativë cilësore.</p> <p>Kjo reflektohet në Aneksin 29 Tabelat Përmbledhëse: 21: Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve dhe tabela 23: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 32 Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Dokumenti 34 Marrëveshje Bashkëpunimi Aktive</i> <i>Dokumenti 35/A. Lista e studentëve që kanë zhvilluar praktikën në vitin akademik 2019 2020, 2020 2021</i> <i>Dokumenti Aneksin 29 Tabelat Përmbledhëse: 21: Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve.</i> <i>Dokumenti Aneksin 29 Tabela 23: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/ module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <i>Në këtë program studimi, në planin mësimor mungojnë lëndët e kategorisë A si lëndë bazë që përbëjnë 15%-20% kredite dhe synojnë përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme.</i> Kjo mungësë evidentohet edhe në dokumentacionin e paraqitur (<i>Dok 14 B Aneksi 29 Tabelat përmbledhëse</i>) por edhe është diskutuar në vizitën në institucion. Formimi profesional i studentëve me njohuri dhe kompetenca në fushën e biznesit, marketingut dhe shitjes kërkon pa diskutim lëndë të formimit bazë që orientojnë atë drejt një culture të përgjithshme apo përgatitje metodologjike. Është orientuar si rekomandim dhe kërkesë në përmirësimet e ardhshme të këtij programi.</p> <p><i>Dokumenti 14 B Plani Mesimor per programin e studimit profesional Teknik ne Operacione Biznesi Marketing dhe Shitje</i> <i>Dokumenti Aneksi 29 Tabelat permbledhese</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përftimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me</p>	<p>Ky program studimi përbën një përpjekje për të furnizuar studentët me aftësi njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse, kjo është dokumentuar edhe në diskutimet me grupin fillestar të stafit të pedagogëve që kanë qënë iniciator në krijimin e këtij program studimi. Kështu psh, klasifikimi apo grumbullimi i lëndëve në 4 module të lëndëve reflekton këtë fakt. Por kjo nuk mohon faktin se zhvillimi dhe përftimi i kompetencave lidhet fort edhe me tregues të tjerë cilësor dhe sasior të cilët mungojnë apo duhet të jenë objekte I</p>

<p>një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>rishikimit të mëtejshëm në përmirësimet e ardhme të kurrikulës. Këto çështje, të përmbledhura më poshtë, u diskutuan si me drejtuesit e fakultetit, njësisë bazë që e ofron këtë program studimi, po ashtu edhe u përmbledhën në takimin e fundit gjatë vizitës në institucion.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aftësimi me njohuri aftësi dhe kompetenca profesionale kërkon më shumë lëndë praktike, dhe jo lëndë të formimit bazë (që mund të bëhen në bachelor apo master). Shumë lëndë si Strategji Çmimesh apo Sjellje Konsumatore apo edhe Marketing Digital i përkasin kategorisë master apo minimum bachelor dhe jo programeve profesionale të studimit. Kjo pavarësisht argumentimit se mund të trajtohen nga këndvështrime të tjera qoftë edhe sociale. 2. Emërtimet e lëndëve të jenë sa më të thjeshta dhe të reflektojnë njohuritë që transmetojnë. Psh Lënda Baza marketing dhe konsumatori të jetë thjesht baza marketing. 3. Përmbajtja e syllabuseve të thjeshtësohet dhe freskohet me literaturë koherente si dhe materiale në gjuhën shqipe. Në lëndë si Baza marketing të thjeshtohen synimet dhe përmbajtja e syllabusit. Psh do të ishte e tepërt që student I këtij program studimi të fitojë kompetencën e ndërtimit të një plani marketing apo metodologjive të tjera që synohen fare mirë në bachelor apo nivele të tjera studimi. Po kështu literaturat e sugjeruara janë mjaft të vjetra, nuk janë më të mirat në treg, dhe kërkojnë një përditësim dhe reflektim të hollësishëm të tregut vendas, dhe më tej me literaturë të huaj; 4. Përplasja e koncepteve midis lëndëve të ndryshme krijon konfuzion dhe pasiguri në marrjen e njohurive dhe rrjedhimisht të kompetencave kyce.
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Në këtë program studimi ofrohen orë dhe kredite të praktikës mësimore në tre nivele: Trajtimi praktikë është pjesë e planit mësimor dhe përfshihet në lëndët plotësuese me 6 kredite dhe në detyrimet përmblyëse me 18 kredite. Pra studentit përfton 24 kredite nga 120 të marra në total. Përveç kesaj, në pothuajse të gjitha lëndët, përfshihet elementi praktikë me 15 orë. Një orientim më i mirë drejt tregut vendas lokal dhe kombëtar, një qasje më e thjeshtë dhe praktike e lëndëve dhe moduleve të përfshira, si dhe një orientim i zhvillimit të praktikës mësimore pranë institucioneve që vërtet kërkojnë aftësi dhe mundësojnë punësimet, do të përbëjnë një mbështetje për të arritur që ky program studimi në të ardhmen të synoj zhvillimin e kompetencave për të manaxhuar dhe mbikëqyrur në kuadrin e veprimtarive profesionale si dhe në orientimin e duhur në situatë të ndryshme dhe të ndryshueshme të tregut.</p> <p><i>Dokumenti C Aneks: Tabela përmbledhese, faqja 7</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/ njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë</p>	<p>Fakulteti në tërësinë e tij, si pjesë aktive e Universitetit mundohet të tërheqë staf sa më të specializuar. Kjo u identifikua edhe gjatë vizitës</p>

përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.

me stafin mësimdhënës pranë këtij departamenti, për këtë program studimi. Për shkak të mungesës së doktorantëve, është tërhequr psh, një pedagoge që ka mbaruar doktoraturën në Itali. Kjo me qëllimin për të patur doktorantë pranë këtij departamenti, dhe rrjedhimisht edhe fakultetit.

Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ka përbërje 3 departamente:

- Departamenti i Drejtësisë
- Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës
- Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës përgjegjës për këtë program studimi ka në përbërje të tij:

Për vitin akademik 20-21:
10 PAE nga të cilët 2 Prof, 2 Prof As, 3 Dr, 3 Msc dhe 17 PAK.

Për vitin akademik 19-20:
7 PAE nga të cilët 1 Prof, 1 Prof As, 4 Dr, 1 Msc dhe 13 PAK

Për vitin akademik 18-19:
7 PAE nga të cilët 1 Prof, 6 Dr/ Phd dhe 5 PAK

Përveç kësaj departamenti përgjegjës për ofrimin e këtij program studimi ka angazhuar edhe pedagogë me kohë të pjesshme duke u munduar të profilizojë ato me lëndët që japin mësim.

Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

Duhet të synohet një përjasje më e fortë midis objektivave të këtij program studimi për formimin profesional të studentëve me atë çka furnizohet studenti përfshirë dijet dhe kompetencat e fituara.

Kështu më shumë lëndë profesionale, një qasje më e fortë me bizneset vendase duke i ftuar edhe në formë e guest speaker, larmishmëria e mësimdhënies duke përfshirë elemente praktikë të bizneseve shqiptare, kryerja e orëve të praktikës së çdo lënde pranë bizneseve vendase sipas profilit të lëndës, do të mbështesin më tej arritjen dhe plotësimin e këtij kriteri.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGrameve TË Studimit Me KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Në rregulloren për programin e studimit “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” të miratuar në Vendim Senati nr 80, datë 13.04.2021 si dhe në mbledhjen e departamentit vjetore/ periodike mbi arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional për vitin 2019- 2020 e zhvilluar në datën 15.09.2020, përbëjnë dy dokumenta që tregojnë arritjen e objektiveve të këtij program si dhe informacione për organizimin dhe strukturën apo fushat e mundshme të punësimit. Këto dokumenta mbajnë datë më të vonshme se sa kur është ofruar për herë të parë, që do të thotë se këto <i>objektiva duhet të ishin përcaktuar në një periudhë më të hershme se sa fillimi i këtij programi studimi, me qëllim që çdo analizë e mëpasme (analizë vjetore apo periodike) të bënte krahasimet me objektivat e vendosura herët në kohë.</i></p> <p>Në fakt në vitin e parë që është ofruar ky program studimi është ofruar nga një departament tjetër, dhe më pas në vitin e 2 dhe të 3 të tij dhe në vijim, ofrohet nga Departamenti i Sipërmarrjes, Financës dhe Ekonomisë.</p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit “Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing” të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p> <p><i>Dokumenti 38. Analiza vjetore/periodike mbi arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi është hapur me Urdhër MASR Nr. 568, datë 12 Shtator 2018. Programi fillon veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 (sipas pikës 2 të këtij urdhëri) (Urdhër Nr.568, datë 2018-09-12). Ky program studimi është i karakterit profesional, është i organizuar në sistemin me kohë të plotë, me 120 kredite, në dy vite akademike dhe i ndarë në semestra. (Plani mësimor sipas tabelës nr 10). Grupimet e dhëna herët dhe të përfshira në tabelën 10 grupojnë lëndët/modulet në 4 kategori. Për secilën lëndë është dhënë informacion mbi orët në leksione, seminare, praktika apo laboratore.</p> <p><i>Dokumenti 14 B Plani Mësimor për programin e studimit profesional Teknik në Operacione Biznesi Marketing dhe Shitje</i></p>

	<p><i>Dokumenti: Aneksi 29 Tabelat përmbledhëse</i></p> <p><i>Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Program i studimit përmban paketën e vet ku përfshihen plani mësimor me elementët e ndarë sipas kategorive, orët në auditor, vlerësimi i dijeve dhe aktivitetet specifike.</p> <p><i>Rekomandohet që syllabuset e lëndëve/moduleve në brëndësinë të tyre të unifikojnë dhe resketojnë formën e kontrollit të njohurive të vendosura në tabelën 15, të rubrikës C Anekse me Tabela, sikurse edhe të reflektohen orët dhe shpërndarja e tyre brenda lëndëve/moduleve përkatëse në tabelën 13 të Anekse C: pasi në këtë tabelë nuk janë të përfshira orët e seminareve.</i></p> <p>Rregullorja e programit profesional përmban elementët e vet të frekuentimit si për praktikën mësimore ashtu edhe për lëndët. (neni 7 dhe 17).</p> <p><i>Dokumenti C Aneks: Tabela përmbledhëse, faqja 7, fq. 15, Tabela 15: Format e kontrollit të njohurive</i></p> <p><i>Dokumenti C Aneks: Tabela përmbledhëse, faqja 7, fq. 15, Tabela 13: Ngarkesa Totale në auditor për format e mësimdhënies në programin e studimit.</i></p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit “Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing” të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Pjesë përbërëse e dokumentacionit të këtij program studimi janë dhe syllabuset e lëndëve të cilat janë të detajuara dhe më të gjitha elementët në brëndësinë e tyre. Nga pikëpamja sasiore syllabuset përmbajnë të gjitha elementet, ndërsa nga pikëpamja cilësore rekomandohen sugjerimet e mëposhtme, të cilat u bënë me dije dhe u dakortësuan dhe nga vizita në institucion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të rifreskohen literaturat e përdorura dhe të cituara - Të thjeshtësohen si objektivat e lëndëve specifike ashtu edhe përmbajtja e syllabuseve (temave). Shpesh vihen re se syllabuse të caktuara janë pothuajse të njëjta me ato që zhvillohen (për të njëjtat lëndë apo module) në nivele bachelor dhe master. - Të ndryshohen emërtimet e lëndëve të caktuara: psh “Baza Marketingu dhe Konsumatori” të bëhet “Baza Marketingu” dhe brenda syllabusit të kësaj lënde të thjeshtohen objektivat dhe rezultatet e të nxënurit. Psh, sigurisht që një student i këtij niveli studimi nuk do të mundet të hartoj dhe implementojë një plan marketing në fund të këtij moduli. Apo të ndërtojë një strategji për të vendosur çmimet, apo të realizojë strategjitë e marketingut digital/ Pra, orientimi është që modulet/lënde, emërtimet e tyre dhe rrjedhimisht edhe

	<p>syllabuset të sillen në formën që ky program studimi kërkon të aftësojë me njohurite e veta. Sugjerohen të përfshihen lëndë me emërtime të shkurtra, të thjeshta, praktike, dhe mundësisht të bazuara në praktikat më të mira në botë dhe të sjellura natyrshëm për tregun shqiptar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të eliminohen përplasjet midis temave të caktuara të përfshira në disa syllabuse lëndësh pasi krijojnë konfuzion. - Lëndë të caktuara janë të një vështirësie relative për studentët e këtij program studimi. Psh lëndët Marketing Digital, Strategjia e Cmimeve, Sjellje konsumatore të sillen në një format më të lehtë ose të zëvendësohen me lëndë të tjera. Ndërkohë që edhe gjuha gjermane mund të zëvendësohet me një lëndë tjetër. Është e mjaftueshme një gjuhë e huaj. Madje sugjerohet që edhe gjuha e huaj që do të vendoset (psh gjuha angleze) të sillet në një nivel Teknik, pasi presupozohet se student që vjen nga bachelor apo edhe nga biznesi e ka një nivel bazik të gjuhës dhe kërkon një nivel të mëtejshëm teknik, edhe në gjuhën e huaj. <p>Në këtë mënyrë, me rekomandimet e sugjeruara dhe të darkotësuara nga vizita në institucion, por edhe me kërkime të detajuara të mëtejshëm të tregut, me takime dhe focus grupe me biznese që vërtet janë të interesuar për këtë kategori të studentëve, do të mund të risillet në një formë të pranueshme dhe fleksibile për tregun e punës në vendin tonë.</p> <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i></p>								
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Elementi praktikës përbën një disiplinë më vete të trajtuar me 6 kredite, ndërkohë që përfshihet edhe në syllabuse të lëndëve/moduleve të caktuara që e parashikojnë me një numër të caktuar orësh (15). Gjithashtu elementi praktikë përfshihet edhe në detyrimet përmbyllese me 18 kredite. <i>Terminologjia e praktikës rekomandohet të unifikohet, pra teksta diku përdoret trajnimi praktik dhe në vende të tjera praktika, është më e kosniderueshme të përdoret një terminologji per të mos ngatërruar konceptin dhe rrjedhimisht njohurite e transmetuara.</i></p> <p><i>Dokumenti Aneks C Tabelat Përmbledhëse, faqja 7</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="665 1704 821 1787">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="821 1704 986 1787">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="986 1704 1193 1787">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1193 1704 1361 1787">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ky program studimi është ndërtuar në përpjekje të zbatimit të ligjit të Arsimit të Lartë dhe me synimin të tërheqë një kategori të studentëve që kërkon të aftësojë për tregun e punës në vendin tonë. Ky program profesional është ndërtuar në kuadër të nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimit, përmban 120 kredite, është organizuar në 2 vite akademike, me kohë të plotë.</p> <p><i>Dokumenti 53, Ligji i Arsimit të lartë, nr 80/2015</i></p>
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	<p>Ky program studimi është munduar të ketë një shpërndarje të lëndëve/moduleve në semestra.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sugjerohet të jepet rëndësia e lëndëve edhe përmes rishpërndarjes së krediteve midis lëndëve. Kështu, jo të gjitha lëndët/modulet të kenë të njëjtin numër kreditesh 6. Disa lëndë me praktikë të kenë një numër më të ulët të krediteve në raport me lëndë të tjera më thelbësore në formimin e përgjithshëm; - Të shtohen lëndë të disiplinës A. Disiplina A nuk është prezente/e pranishme në planin mësimor, rrjedhimisht ky plan mësimor konsiderohet i paplotë. Mungesa e kësaj discipline u konstatua dhe dakortësua dhe nga vizita në institucion me stafin, grupin e RVB dhe me drejtuesit e njësisë bazë dhe të fakultetit. - Mundet të riorgaizohet edhe shpërndarja e orëve në praktikën mësimore. Sikurse është përmendur elementi praktikë merr 3 forma përfshirjeje: si lëndë më vete me 6 kredite, si pjesë e orëve të lëndëve/moduleve të veçanta (15 orë) dhe, si disiplinë më vete Rubrika e Detyrimeve Përmbyllese. Duke patur parasysh se elementi praktikë është bazik dhe shoqëron transferimin e njohurive, institucioni mund të konsiderojë nëse e sheh të arsyeshme rishpërndarjen e krediteve dhe të orëve të praktikës mësimore. <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Planin Mësimor</i> <i>Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse</i></p>
Kriteri 3. Planin mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha	<p>Në këtë program studimi, në planin mësimor mungojnë lëndët e kategorisë A si lëndë bazë që përbëjnë 15%-20% kredite dhe synojnë përgatitjen metodologjike dhe kulturen e përgjithshme. Kjo mungesë evidentohet edhe në</p>

<p>elementet e kërkuara.</p>	<p>dokumentacionin e paraqitur (<i>Dok 14 B Aneksi 29 Tabelat përmbledhëse</i>), por edhe është diskutuar në vizitën në institucion.</p> <p>Vihen re disa veçori në syllabuset e lëndëve/moduleve të këtij program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jo të gjitha syllabuset kanë të njëjtën ndarje të formës së kontrollit të njohurive të vendosura paraprakisht në tabelën 15 të anekseve me tabela. Kjo formë e kontrollit shpesh ndryshon midis syllabuseve nga ajo që është përcaktuar; - Elementët e literaturës shpesh janë të vjetëruar dhe nuk përfshijnë materiale të gjuhës shqipe. Është e nevojshme që leksionet bazë të jepen në gjuhën shqipe në formën e materialeve të pedagogutt e lëndë apo teksteve në shqip, sikurse të shoqëruara edhe me literaturë angleze. Konsiderojmë të rëndësishëm që të përfshihen literaturat më të mira në tregun vendas nga autorë shqiptarë apo të përkthyer sikurse edhe përditësim të literaturës së huaj. - Sugjerojmë të rishikohen objektivat dhe synimet që përmbajnë lëndët/modulet pasi disa herë janë më të ngarkuara dhe i kalojnë objektivat e këtij program studimi profesional. <p><i>Dokumenti C. Aneks Tabela Përmbledhëse: Tabela 15, Forma e kontrollit të njohurive, fq 15.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion.</p>	<p>Në tabelën 13 Ngarkesa Totale në auditor për format e mësimdhënies në programin e studimit për secilin program jepet një shpërndarje e orëve totale në auditor sipas formave të mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Leksione 480 orë;</i> - <i>Ushtrim dhe laboratorë: 300/180</i> - <i>Praktikë profesionale 120</i> - <i>Total 1080 orë</i> <p>Ndërkohë që elementi i praktikës i vendosur herë si Trajnimi praktik përfshihet edhe në kategorinë e lëndëve plotësuese me 6 kredite dhe Detyrimet përmblylëse me 18 kredite, pra me një total prej 24 kreditësh. Ndërkohë që edhe lëndë apo module të veçanta e përmbajnë këtë element në emërtimin Praktika me orë më vete mësimore. Në tërësinë e vet ky kriter plotësohet. Laboratorët dhe praktika profesionale përbëjnë 27.7% të programit.</p> <p><i>Dokumenti C. Aneks Tabela Përmbledhëse: Tabela 13, Ngarkesa Totale në auditor për format e mësimdhënies në programin e studimit për secilin program, fq 15, fq 7</i></p>

<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ky program studimi bën një përpjekje për të mundësuar raportin midis aktiviteteve formuese për të arritur objektivat e tij. Ky program studimi klasifikon në 4 grupime lëndët/modulet për të riorganizuar dhe grupuar njohuritë sipas lëndëve të ofruara. Ky klasifikim sugjerohet të mbahet në çdo organizim të mëtejshëm sepse orienton studentin për grupimin e njohurive që synon të marrë dhe përftojë.</p> <p>Me qëllim zbatimin e objektivave të vendosura në rregulloren e këtij program studimi, në të ardhmen duhet të kihet parasysh përveç të tjerave edhe përfshirja dhe prezenca e kategorisë A në planin mësimor.</p> <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i> <i>Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse</i> <i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit "Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing" të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.3 Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit ofron informacion të plotë në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe vihet re një përpjekje pozitive e stafit të angazhuar në këtë program studimi si dhe veçanërisht e atij grupimi që ka inicuar krijimin dhe lancimin e këtij program profesional.</p> <p>Kështu klasifikimet në 4 module, ndarjet e orëve dhe krediteve, informacioni në syllabuse janë një përpjekje për të plotësuar informacionin dhe për t'a ofruar atë tek studentët dhe palët e interesuar.</p> <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i> <i>Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse</i> <i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit "Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing" të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e</p>	<p>Me të gjithë sugjerimet e mësipërme, përmbajtja e këtij program mund të jetë vërtet aktuale. <i>Në këtë formë që është ky program ka probleme si në formë ashtu dhe në përmbajtje, si në mungësë të elementëve bazikë të planit mësimor (disiplina A) ashtu edhe</i></p>

<p>kërkuara/ të pritshme nga punëdhënësit.</p> <p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p><i>në brëndësi të syllabuseve apo riorganizime të lëndëve të veçanta.</i></p> <p>Përmes ndarjes në 4 module mundësohet shpërndarja e njohurive midis manaxhimit, marketingut dhe shitjes apo operacioneve të biznesit, duke u munduar të bëhet një grupim apo klasifikim i njohurive përkatëse. Ky program studimi nuk ka bërë përmirësime në kurrikulën e vet përgjatë 3 viteve që është ofruara (tashmë është në vitin e katërt të tij 2021- 2022). Ndërkohë që stafi dhe studentët shprehen për nevojë të rishikimit të tij, të një përqsasjeje më të madhe me tregun shqiptar, të përfshirjes së më shumë lëndëve të thjeshta dhe konkrete që i shkojnë një program profesional, etj. Ky vlerësim nga GVJ me sugjerimet e veta të dakortësuara edhe nga vizitat ne institucion dhe të bëra publike në takimin përmbyllës do të mbështesë UniBA në ndërtimin e një kurrikule cilësore me të gjithë elementët e vet.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p> <p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, dhe veçanërisht nga plani mësimor dhe syllabuset, vihet re një ngarkesë e elementit teorik që nuk i përket këtij program studimi (por fare mirë mund të jetë për nivele të bachelorit apo masterit). Metodologjia e lëndëve të caktuara është relativisht më e vështirë për t'u përthithur nga ky grupim apo kategori e studentëve. Përbërja e syllabuseve duhet të thjeshtësohet, të përfshihet më shumë elementi praktik, praktika te synohet të realizohet në ato instiutcione që do të tërheqin dhe punësojnë këtë kategori të studentëve, të synohet për kontrata më efçente në këtë mënyrë, dhe të testohen më shumë transferimet e njohurive nga teoria ne praktikë përmes përfshirjes së praktikave më të mira, te aplikimit të tyre në laboratorë apo instiuttcione të ndryshme, të përfshirjes së guest speakërve nga bota aktuale e biznesit shqiptar etj. Përfshirja e elementit praktikë më shumë orë mësimore dhe më shumë kredite është një mundësi e mirë që studenti të testojë njohuritë e marra nga lëndët teorike, dhe institucioni bën një përpjekje për t'a realizuar dhe mundësuar këtë. Por duhet të kihen parasysh të gjitha sugjerimet e mësipërme me qëllim që ky kriter të mirë plotësohet edhe në të ardhmen.</p> <p>Ka vend për më shumë bashkëpunim me punëdhënësit, për një intership më cilësor dhe të realizuar pranë institucioneve që kanë nevojë për këtë kategori të studentëve.</p> <p>Ndërkohë sugjerohet një përfshirje më e madhe e botës së biznesit shqiptar në çdo veprim, përmirësim apo ndryshim të këtij program mësimor. Sugjerohet një bashkë-krijim i kurrikulës me biznesin, një përfshirje me active të grupeve apo nismave të krijuara brenda departamentit apo fakultetit me qëllimin e përmirësimit cilësor dhe efçent të këtij program studimi.</p> <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i> <i>Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse</i></p>

	<p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit “Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing” të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të studimit “Teknik në Shitje, biznes dhe Marketing” të miratuar në Vendim Senati nr 80, 13.04.2021</i></p> <p><i>Dokumenti 38. Analiza vjetore/periodike mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe të aftësimit profesional</i></p> <p><i>Dokumenti 34 Marrëveshje të bashkepunimit aktive</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Universiteti Barleti ka në vëmendje rritjen dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë. Kjo reflektohet edhe nga numri i konsideruar i njësive që ka ngritur për këtë qëllim.</p> <p>Njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe e cilësisë në muajin tetor të 2020 ka ndërtuar dokumentin 39 A “Manuali i mësimdhënies online” i cili ka reflektuar pa dyshim gadishmërinë e të gjithë stafit për të realizuar mësimdhënie efëcente gjatë kohës së pandemisë. Po kështu në mars të 2020 ka ndërtuar dokumentin Guidë për mbështetjen e mësimdhënies online. Këto dy dokumenta janë të rëndësishëm dhe kanë shërbyer pa dyshim si dokumenta orientues për gjatë gjithë kohës së mësimdhënies online. Por ky program studimi i ka fillesat e veta në vitin 2018 – 2019 përgjatë së cilit është lançuar për herë të parë, dhe nevoja për të patur një udhëzues të posaçëm që do të shoqëronte lançimin dhe zhvillimin për herë të parë të këtij program sigurisht që ka qenë prezente. <i>Institucioni nuk ka një udhëzues të posaçëm që orinton zhvillimin e mësimdhënies por ka dok bashkëshoqërues që janë krijuar në vitet 2020 2021 të kohës së pandemisë së Covid 19.</i> Pavarësisht strukturave shoqëruese që kontrollojnë cilësinë e mësimdhënies, është e nevojshme pasja e një dokumentit të tillë në të ardhmen pasi konsiderohet strategjik për mësimdhënien.</p> <p>Përfshirja e studentëve është aktive dhe merret mendimi i tyre për këtë proces.</p> <p><i>Dokumenti 39 A Manuali i mësimdhënies online</i> <i>Dokumenti 39 B Guide instructive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies online</i> <i>Dokumenti 40 Pyetësori i studentit</i> <i>Dokumenti 66 Vlerësimi i studentëve, raport përmbledhës</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/ eseja, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Format e mësimnxënies janë të sqaruara dhe të standartizuara në tabelën 15, fq 15 të aneksit të tabelave, dhe shpjegon se program i studimit Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje ka format e mëposhtme të kontrollit të njohurive:</p> <p>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: 10% Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20% Testime gjatë vitit 20% Provimi perfundimtar 50%</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor</p>	<p>Kjo formë presupozohet të vendosë një standartizim në</p>

<p>forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>mënyrën dhe formën e kontrollit të njohurive, ndërkohë që vihet re në syllabuse të caktuara të lëndëve të këtij program studimi se kjo formë nuk respektohet, dhe se lëndë të ndryshme kanë formate të ndryshme të kontrollit të njohurive. Përpos kësaj, gjatë vizitës në institucion, studentët u pyetën për llojet e testimeve që u bëhen përgjatë vitit, përsa kohë që Testimet gjatë vitit janë element i vlerësuar me 20% të kontrollit të njohurive. Nga studentët nuk u paraqit ndonjë përgjigje e saktë apo orientuese për këtë element.</p> <p>Ndërkohë që vihen re përpjekje cilësore nga personeli akademik për të përmirësuar metodat dhe mundësitë alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Personeli akademik, i brendshëm dhe i jashtëm mundohet të përmirësojë kualifikimin e vet, si përmes botimeve dhe kjo tregohet nga gadishmëria e universitetit për të mbuluar botimet akademike të stafit, ashtu edhe përmes pjesëmarrjes në konferenca.</p> <p>Raporti PAE dhe PAK për vitin akademik 2019 – 2020:</p> <p>7 PAE nga të cilët (1 Prof As, 4 Msc, 2 Mp) dhe 2 PAK (1 Prof, 1 Msc)</p> <p>PAE = 90%, PAK = 10%</p> <p>Raporti PAE dhe PAK për vitin akademik 2020 – 2021:</p> <p>10 PAE nga të cilët (1 Prof As, 1 Dr, 7 Msc, 1 Mp) dhe 3 PAK (1 Dr, 2 Msc)</p> <p>PAE = 87,5%, PAK = 12,5%</p> <p>Raporti PAE dhe PAK për vitin akademik 2021 – 2022:</p> <p>11 PAE nga të cilët (1 Prof AS, 1 Dr, 9 Msc) dhe 2 PAK (1 Dr, 1 Msc)</p> <p>PAE = 85%, PAK = 15%</p> <p><i>Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 14B Plani Mësimor</i> <i>Dokumenti C Aneks: Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Vihet re një ngarkesë e madhe e stafit të brendshëm në mësimdhënie gjë e cila shoqërohet me numër të lartë të orëve të zhvilluara përgjatë një semestri. Stafit është i angazhuar në 1 deri në 2 lëndë mësimore të këtij program studimi dhe pjesa tjetër e ngarkesës së stafit të brendshëm mësimor realizohet në programe të tjera studimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u vu re një përkushtim i stafit për të realizuar një cilësi sa më të mirë mësimdhënie e cila e shoqëruar dhe me numrin e lartë të njësive që kontrollojnë cilësinë apo vlerësojnë performancë, garantojnë një cilësi të mirë mësimdhënie për këtë program studimi.</p>

	<i>Dokumenti Anes C: Tabelat përmbledhëse: Tab 1 fq 1-4: Numri i personelit akademik për cdo njësi bazë</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Testimet e studentëve, zyrat e kontrollit të cilësisë, të performances por edhe e gjithë struktura mbështetëse mundëson fare mirë që i gjithë stafi i brëndshëm dhe i jashtëm të ofrojë njohuritë më të mira. Nga ana tjetër, prania e laboratorëve të ndryshëm brenda UniBa, biblioteka dhe qasja më e madhe me tregun dhe bizneset më të mira do të mundësojnë ofrimin e praktikave më të mira. Sugjerohet që Bordi i Karrieres i ngritur brenda departamentit për këtë qëllim të jetë më aktiv dhe të shërbëjë më mirë në ofrimin e këtyre praktikave nga jashtë, pra nga biznesi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	UniBa ka vendosur në dispozicion të këtij program studimi hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, mjaft bashkëkohore dhe janë të pajisura me të gjithë logjistikën e nevojshme për realizimin e tyre. Kjo u evidentua dhe nga vizita në institucion por edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të këtij vlerësimi. <i>Dokumenti 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 42 b Të dhëna për infrastrukturën</i>
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Gjatë takimit me studentët u diskutua mbi infrastrukturën e vënë në dispozicion për të zhvilluar si orët e leksioneve, seminareve apo ato laboratorike. Studentët kanë përdorur mjaft mirë dhe shpesh platformën google classroom dhe ende e përdorin atë për të patur akses me leksionet apo njoftime të tjera. <i>Dokumenti 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 42 b Të dhëna për infrastrukturën</i>
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Përmes syllabuseve GVJ u bë me dije për literaturë që përdor stafi dhe u dakortësua për rifreskimin dhe përditësimin e tyre me literaturë të viteve të fundit, por edhe me literaturë cilësore në gjuhën shqipe. Edhe nga vizita në Bibliotekën e universiteti u vu re një përpekje e tyre për të patur dhe grumbulluar të gjithë literaturë më të mirë në gjuhën shqipe. Sugjerohet që në syllabuset e lëndëve kur vendosen cikle të leksioneve të pedagogut si literaturë e parë, të përfshihen edhe literaturat në gjuhën e huaj mbi të

	<p>cilën janë bazuar për të ndërtuar ciklet përkatëse.</p> <p><i>Dokumenti 42 C Dokumenti për Bibliotekën TOMBsh</i> <i>Dokumenti 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 42 b Të dhëna për infrastrukturën</i> <i>Dok 19 Syllabuset</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në dokumentin 42 D jepen të dhëna për platformën online të përdorur dhe mundësuar nga UniBa. JSTOR, ECONBIZZ dhe SEARCH4LIFE, janë disa nga platformat e vendosura në dispozicion të stafit dhe studentëve. Është e rëndësishme dhe sugjerohet fortë që studentët të orientohen drejt përdorimit të literaturës ekstra që forcon njohuritë e tyre profesionale. Lista e konferencave, workshopeve dhe trajnimeve reflekton përdorimin e një literature të gjerë nga stafi i këtij program studimi.</p> <p><i>Dokumenti Aneks 42 (d) Të dhëna të plotë për platformat online/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka online</i></p> <p><i>Dokumenti 43 (A) Lista e konferencave, workshopeve dhe trainimeve</i></p>			
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Pavarësisht numrit të ulët të studentëve të diplomuar në totalin e 3 viteve që është ofruar ky program studimi, nga vizita në institucion u identifikua një infrastrukturë e bollshme dhe e nevojshme për studentët për të kryer realizimin e çdo detyrimit të tyre përgjatë vitit dhe të përfshirë në syllabus. Është e rëndësishëm vetëm që të orientohen sa më shumë studentët drejt përdorimit të tyre si dhe të përfshihen sa më shumë ato në studime konkrete të tregut të punës së bashku me stafin. Sugjerohet që detyra të tilla të kursit apo diploma të tyre të orientojnë nga tregut duke i përfshirë studentët “në formate mini studimesh të tregut” se cilit ato vetë do t’u shërbejnë.</p> <p><i>Dokumenti 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 42 b Të dhëna për infrastrukturën</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Informacioni, infrastruktura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të stafit të brendshëm dhe të jashtëm është cilësore, e bollshme dhe mjaft e përditësuar. Kjo gjë u vu re vecanërisht përgjatë vizites në institucion.</p> <p><i>Aneks 42 (d) Të dhëna të plotë për platformat online/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka online</i> <i>Dokumenti 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 42 b Të dhëna për infrastrukturën</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	Nok përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p> <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas statusit të këtij institucioni (<i>Dok 2 Statusi IAL</i>), brenda këtij institucioni janë ngritur disa njësi që janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e cilësisë dhe kontrollit të performancës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia e zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC) me një dretues dhe 3 kordinatorë; • Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta; • Komisioni i Vlerësimit të Performancës; • Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilesisë; <p>Përveç kësaj departamenti përgjegjës për ofrimin e këtij program studimi ka angazhuar edhe pedagoge me kohë të pjesshme duke u munduar të profilizojë ato me lëndët që japin mësim. Por së pari, është departamenti si njësia kryesore përgjegjëse e ofrimit të këtij program studimi e cila është përgjegjëse për mbarëvajtjen e këtij program, e kontrollon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe reflekton përmes raporteve dhe analizave vjetore/periodike. Institucioni ka vendosur një procedurë e cila përfshin së pari departamentin që është përgjegjës për këtë program studimi, stafin që angazhohet në mësimdhënie me kohë të plotë e të pjesshme përmes raprtimeve dhe informacioneve të dhëna nga to, sikurse dhe përmes njësive të tjera. Kështu, ngritja e strukturës Dekani i Studentit është një qasje mbështetëse dhe positive për studentin dhe për ta përfshirë jo vetëm në qasjet sociale të institucionit por edhe ato edukuese, mësimdhënëse të përditshme me të cilat përballen studentët.</p> <p><i>Dokumenti 2. Statuti IAL</i> <i>Dokumenti 6 B: Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Financës dhe Sipërmarrjes.</i> <i>Dokumenti 36B Kordinatori i departamentit</i> <i>Dokumenti 37. Raporti i vlerësimit të brendshëm të studentëve</i> <i>Dokumenti 38. Analiza e departamentit për objektivat</i> <i>Dokumenti 38b Raporti i mbledhjes së departamentit datë 10.09.2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën</p>	<p>Universiteti Barleti në dokumentacionin e vet bazë ka përcaktuar qartë detyrat e personelit akademik dhe ndihmësakademik duke specifikuar përgjegjësitë e tyre për zbatimin e programeve të studimit si dhe për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p>Nga ana tjetër, mundësitë që ofron UniBa përmes</p>

dhe specifikën e programeve profesionale.	<p>programeve të shkëmbimit Erasmus si të stafit ashtu edhe studentëve janë një mënyrë e mirë për të motivuar dhe nxituar ato drejt mësimdhënies dhe metodologjisë së re.</p> <p><i>Dokumenti 5 Rregullore e institucionit, neni 53-53.</i> <i>Dokumenti 7. Rregullore e programit profesional TOMBSH</i> <i>Dokumenti 43 C Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p> <p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë Sipërmarrjes dhe Financës është përgjegjëse për implementimin dhe zbatimin e monitorimin e këtij program studimi. Së bashku me këtë departamenti impenjohet edhe NjKZhC (Njesia e zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC) me një dretues dhe 3 kordinatorë).</p> <p><i>Dokumenti 5 Rregullore e institucionit</i></p> <p>Metodat e reja, inovative dhe të bazuara në teknologji që diktoi periudha e covid 19 ndihmoi dukshëm institucioet e arsimit të lartë në implementimin e metodologjisë online mësimdhënëse, e cila jo vetëm që rriti inovacionin por shtoi dhe larmishmërinë e përdorimit të tyre. Të dhënat, guidat dhe manualat e përdorura për këtë program studimi i përkasin periudhës pas vitit 2020. Sugjerohet që në mbledhjet e departamentit apo në analiza vjetore të diskutohet edhe mbi përbërjen e syllabuseve sepse ato reflektojnë direkt njohuritë e marra në teori. Kjo për qëllimin e ndarjes së njohurive midis stafit të brendshëm që të mos ketë mbivendosje në konceptë teorike të marra, të mos ketë problematika e koncepte të përsëritura, dhe të ketë një siguri për transmetimin cilësor të njohurive tek studentët.</p> <p><i>Dokumenti Aneks 42 (d) Të dhëna të plotë për platformat online/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka online</i> <i>Dokumenti 39 A Manuali i mësimdhënies online</i> <i>Dokumenti 39 B Guidë instructive për mbështetjen dhe pasurimin e mesimdhënies online</i> <i>Dokumenti 40 Pyetesori i studentit</i> <i>Dokumenti 66 Vleresimi i studenteve, raport permbledhes</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e këtij program studimi mbulon të gjitha çështjet që lidhen me këtë kriter që në hyrje e deri në dalje të studentëve. Ndërkohë që në mënyrë të përgjithshme janë specifikuar edhe në Rregulloren e UniBa. Departamenti se bashku me kordinatorin kanë detyrën dhe përgjegjësinë e informimit në çdo fillim semestri apo viti akademik të bërjes publike të procesit dhe ankimimeve apo elementëve të tjerë.</p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e programit professional TOMBSH</i> <i>Dokumenti 5. Rregullorja e institucionit</i></p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Është e rëndësishme që të zbatohet nga të gjithë stafi i brendshëm dhe i jashtëm në bërjen e syllabuseve të standartit të unifikuar të kontrollit të njohurive i përcaktuar në Aneksin C. Në këtë mënyrë do të jenë të unifikuara për të gjitha lëndët, përmes syllabuseve, se cilat janë format e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive dhe do të jenë të standartizuara.</p> <p>Format e vlerësimit mundësohen përmes testeve përgjatë vitit, dhe kjo është e shprehur edhe në formatin e kontrollit të njohurive në syllabuset përkatëse. Përveç testeve të mbuluara me një numër të caktuar të pikëve dhe përqindjes (20%), bëhen edhe përmes detyrave, seminareve kuiceve, etj. Infrastruktura mjaft e pasur dhe e bollshme, numri i I madh i clubeve dhe laboratoreve që ka universiteti mundëson bërjen e seminareve, apo fitimin e guest speakerve në mënyrë të shpeshtë dhe cilësore, gjë e cila jo rrit larmishmërinë e mësimdhënies, por rrit dhe mundëson dhe kontrollin e mësimnxënies.</p> <p>Departamenti, si njësi bazë që zbaton dhe monitoron këtë proces është direkte përgjegjëse për të kontrolluar dhe vlerësuar se si testohen aftësitë dhe ofrohen njohuritë, dhe përmes mbledhjeve dhe raportimeve vjetore raporton këtë në mënyrë publike.</p> <p>Nga ana tjetër, në vizitën në institucion u vu re se jo për të gjitha lëndët dorëzohen në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalin edhe tabela në eksel e shpërndarjes së pikëve dhe përmbledhjes së vlerësimit për çdo student. Kjo përbën një transparencë për të gjithë studentët sikurse dhe unifikon dhe vë në jetë zbatimin dhe standartizimin e Formës së Kontrollit të dijeve.</p> <p><i>Dokumenti Aneks C Tabela 15, fq 15, Forma e kontrollit të njohurive</i> <i>Dokumenti 40 Pyetësori i studentit</i> <i>Dokumenti 66 Vlerësimi i studentëve, raport përmbledhës</i> <i>Dokumenti 7. Rregullore e programit professional TOMBSH</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet</p>	<p>Përgjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me studentët u pyetën mbi mënyrën e marrjes së pikëve dhe vlerësimeve të</p>

<p>gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> <p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>tyre individuale. Nga ana e tyre u bë me dije se ato përdorin systemin e google platform për të hedhur lekskionet online apo për të ndarë opinione dhe informime të tjera nga pedagogët për studentët.</p> <p>Edhe në raportin e vlerësimit të brëndshëm por edhe gjatë vizitës në institucion u diskutua mbi formën e unifikuar të kontrollit të dijeve, por u vu re se kjo formë nuk zbatohet gjithnjë në syllabuset e lëndëve apo moduleve përkatëse.</p> <p>Duke u aplikuar e njëjta formë do të ndihmojë studentët që të kenë një orientim të qartë se dijet e tyre kontrollohen njëjloj në të gjitha lëndët, dhe do ti përgatisë ata më mirë për t'i paraprirë çdo elementi.</p> <p>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: 10% Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20% Testime gjatë vitit 20% Provimi perfundimtar 50% <i>Dokumenti Aneks C Tabela 15, fq 15, Forma e kontrollit të njohurive</i> <i>Dokumenti 7. Rregullore e programit profesional TOMBSh</i></p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Dokumenti i Vlerësimit përmbledh vlerësimet e studentëve si dhe përfshihen në Regjistrin e rezultateve Akademike.</p> <p>Së bashku me procesverbalet e dorëzuara nga pedagogët jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi I provimit sugjerohet të vendoset si procedurë edhe dorëzimi I pikëzimit në tabelat eksel përmbledhëse për të informuar në çdo kohë studentin dhe për të bërë me dije dhe transparencë ndarjen e pikëve për çdo student, për çdo formë kontrolli, dhe për çdo lëndë.</p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e programit profesional TOMBSh</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për</p>	<p>Programi i studimit TOBMSH nga pikëpamja e mënyrës së konceptimit të lëndëve dhe të silabuses ka nevojë të përmirësohet. Duhet qartësuar fillimisht çfarë kompetencash do të formojë ky program studimi, çfarë lëndësh dhe modulesh bazë duhen për t'i krijuar këto kompetenca. <i>Programi aktual paraqet një sërë problematikash qoftë nga pikëpamja strukturore e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore,</i></p>

<p>programet me karakter profesional.</p>	<p><i>qoftë nga pikëpamja e parimeve të të nxënësve. Qoftë në emërtim, qoftë në përmbajtje silabusesh shfaqen problematika. Një element tjetër që evidentohet është mbivendosja në përmbajtje dhe në emërtim lëndësh, si dhe lëndë me tituj shumë të gjatë deri në pa kuptim.</i></p> <p><i>Dokumenti 14.b. Plani mësimor i ndarë në veprimtari</i></p> <p><i>Dokumenti 19. Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit bën përpjekje të garantojë njohuritë e në zhvillimin e aftësive të veçanta. Në silabuset e lëndëve evidentohet që në seminare synohet të përdoren diskutime në grup të rasteve studimore.</p> <p>Vihet re që njohuritë dhe aftësitë në komunikim synohen të krijohen përmes disa lëndëve, duke krijuar dhe mbivendosje.</p> <p>Lënda “Puna në grup dhe komunikimi – Etika në punë dhe komunikimi” mund të konceptohet ndryshe. Dikshëm mungon një lëndë Bazat e Menaxhimit, në të cilën mund të përshihet dhe Puna në ekip dhe etika. Komunikimi dhe Komunikimi online mund të bashkohen në një lëndë.</p> <p>Lënda “TIK Në shkolla dhe shoqëri – Menaxhimi i proceseve të punës” nuk qëndron me këtë formulim për këtë program studimi. Mundet që “Bazat e informatikë” do të ishte më afër programit TOBMSH.</p> <p>Lëndët “Bazat e programimit për marketing”, “Njohuri programimi për shitjet online” dhe “Marketingu digjital”, “Sisteme digjitale të shitjes” duhet të rishihen dhe riorganizohen.</p> <p><i>Dokumenti 14.b. Plani mësimor i ndarë në veprimtari</i></p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>“Trajnim praktik” zë një pjesë të rëndësishme në këtë program studimi, 20% e krediteve të programit TOBMSH shkon në funksion të krijimit të aftësive praktike tek studentët. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim japin bizneset, qendrat dhe insitutet e Grupit Barleti.</p> <p>Ndonëse ka përpjekje të institucionit për të nënshkruar një numër marrëveshjesh me organizata për zhvillimin e praktikës së studentëve, këto marrëveshje duhet të fokusohen më pranë organizatave ku studentët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre në përputhje me kompetencat që ky program krijon. Nga pikëpamja e dokumentacionit institucioni ka formuluar “Paketën e Praktikës”.</p> <p>Gjithashtu, nga pikëpamja formale e kategorizimit të “Trajnimit praktik” në kurrrikul dhe e shpërndarjes së krediteve duhet të rishikohet nga institucioni.</p> <p><i>Dokumenti 14.b. Plani mësimor i ndarë në veprimtari</i></p> <p><i>Dokumenti 34: Marrëveshje e bashkëpunimeve aktive</i></p>

	<i>Dokumenti 32 a: Paketa e praktikës</i>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në Rregulloren e Universitetit dhe në Rregulloren e programit TOBMSH, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të dijës dhe kompetencave të formuara e të zhvilluara gjatë zhvillimit të lëndëve. Nga pikëpamja formale një pjesë e silabuseve paraqesin disa problematika në përcaktimin e formave të vlerësimit, ndonëse në rregullore janë qartë. Kjo gjë u evidentua dhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e programit TOBMSH</i></p> <p><i>Dokumenti 19: Silabuse</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit TOBMSH, për të fituar Diplomen Profesionale në TOBMSH, studenti duhet të ketë marrë 120 ECTS. <i>Ndonëse si detyrim mbyllës konsiderohet "Trajnimi Praktik" institucioni mundet të mendojë për një Projekt Praktik.</i></p> <p>Sekretaria Mësimore në përputhje me rregulloret e institucionit dokumenton të gjithë informacionin mbi ecurinë akademike të studentëve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Sekretaria mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Gjatë vizites në institucion evidentuam që proces verbalet e komponentëve të vlerësimit brenda lëndëve të studentit një pjesë administroheshin nga sekretaria dhe një pjesë nga departamenti.</p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e programit TOBMSH</i></p> <p><i>Dokumenti 14.b. Plani mësimor i ndarë në veprimtari</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 9: Rregullore për funksionimin e Sekretarisë Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për administrimin e programit mësimor, koordinatori i programit, koordinatori i praktikës, Zyra e Alumnit dhe Karrierës, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore mbështesin studentët në realizimin e gjithë detyrimeve të tyre, realizimin e praktikës mësimore dhe bashkëpunimin me tregun e punës.</p> <p>Programi mësimor si detyrim mbyllës ka praktiken, studentët nuk bëjnë punim diplome dhe as provim përmbylles. Në lidhje me studentet që bëjnë punim diplome, ata orientohen heret mbi menyren se si duhet të zhvillohet, edhe studentet asistohen gjatë këtij procesi jo vetëm nga pedagogu udhëheqës por edhe ekipi i fakultetit apo departamentit që është në mbështetje të studenteve. Një rol të rëndësishëm luan sidomos Dekani i Studenteve.</p>

	<i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore (BNJ) synon që përmes veprimtarisë së saj të kontribuojë për funksionimin sa më efikas të UniBA, arrijen e qëllimeve dhe objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit 2020 -2030 dhe në përputhje të plotë me Rregulloren e Universitetit</p> <p>E gjithë veprimtaria e kësaj Zyre mbështetet në një tërësi procedurash e rregullash të cilat janë pjesë e Manualit të Bnj.</p> <p>Në lidhje me procesin e rekrutimit, Zyra e Bnj në përputhje me nevojat e departamenteve, shpall vendet vakante dhe në bashkëpunim me departamentin realizon procesin e selektimit dhe të punësimit të aplikantëve. Thirrjet për pozicionet që hapen shpallen në ëeb-site e universitetit</p> <p><i>Dokumenti 3: Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 11: Manuali i Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Dokumenti 47: Shpallja e vendeve vakante</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor- shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Bazuar në Manualin e Bnj, Zyra e Bnj ka përgjegjësinë që të mbledhë, ruajë dhe përditësojë dosjet e personelit, akademik, administrative. Zyra e Bnj në përputhje me formatin, mbledh dhe administron Dosjet e Personelit.</p> <p><i>Së pari, sugerojmë që Formatin e Dosjes së Personelit të jetë një dokumenti i miratuar, jo thjeshtë i vulosur.</i></p> <p><i>Së dyti, dosja e pedagogut në Bnj do të duhet të përditësohet (nisur nga CV e pedagogut, që u vendos në dispozicion gjatë vizitës në institucion)</i></p> <p><i>Së treti, dosja e personelit do të duhet të përmbajë dhe file e çdo viti akademik, nënkuptuar si raportim ngarkesë mësimore, punë në projekte, punë shkencore, punë administrative, vlerësimi nga pyetësorët e studentëve, drejtuesit dhe njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë.</i></p> <p>Nisur nga vëzhgimet e bëra gjatë vizitës në UniBA, por dhe nga Rregullorja e UniBA, një pjesë e funksioneve të Zyrës së Bnj, mbulohen nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Drejtuesi i kësaj Zyre, një strukturë që lidhet me kulturën dhe strukturën e institucionit dhe që funksionon si e pavarur nga Zyra</p>

	<p>Bnj.</p> <p><i>Dokumenti 11: Manuali i Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Dokumenti 44: Formati i dosjes së personelit</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 11.a: Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës</i></p> <p><i>Dokumenti 11: Udhëzim i UniBa, Nr 61, 19.02.2019. Mbi Mbledhjen e KVP.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UniBA në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit Profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Shitje dhe Marketingu” një sërë aktesh dhe rregulloresh të brendshme dhe investimin në kampusin e ri, bën përpjekje për të siguruar një mjedis social dhe fizik që nxit stafin akademik dhe administrative për të plotësuar më së miri detyrat.</p> <p><i>Dokumenti 3: Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030;</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani i Zhvillimit të Programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>UniBA në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit për të qenë një universitet digjital, inovativ, sipërmarrës si dhe i mbështetur nga pikëpamja strukturore nga disa qendra, institute të Universitetit dhe të Grupit Barleti, ka synuar dhe konceptuar një model institucioni inovativ. Ky model institucioni ka sjellë dhe një dinamikë në konceptimin e punës së pedagogut dhe në zhvillimin e tij profesional. Për periudhën e marrë në konsideratë për akreditim, 7 (shtatë) pedagogë të programit TOBMSH janë përfshirë në projekte.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik u shpreh që kanë marrë mbështetje dhe në drejtim të kërkimit shkencor, botimeve, pjesëmarrjeve në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare, bazuar në kërkesat që bëjnë ndonëse nuk ka një buxhet të miratuar që i dedikohet financimit të kërkimit.</p> <p>Periudha e akreditimit të programit përkon me atë të pandemisë dhe të kalimit të mësimin on –line, për rrjedhojë UniBA ka organizuar një sërë trajnimesh me stafin akademik për mësimdhënien online</p> <p><i>Dokumenti 3: Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030;</i></p> <p><i>Dokumenti 43. d: Projekte të Zbatuara dhe në Proces Grupi Barleti,</i></p> <p><i>Dokumenti 43 a: Lista e konferencave, Ëorkshop, trajnimeve 2015-2020</i></p> <p><i>Dokumenti 43. b: Lista e aktiviteteve ndërkombëtare 2015-2020,</i></p> <p><i>Dokumenti 39 a: Manual i mësimdhënies online</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional				X
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UniBA këtë vit akademik ka kaluar në kampusin e ri, i cili përbën një strukturë moderne, konceptuar dhe realizuar për ta bërë universitetin më inovativ duke patur ambiente që ndërthurin më së miri mësimin teorik, me labororet e informatikës dhe pjesën praktike të qendrave, institutive dhe njërive të tjera të biznesit të Grupit Barleti. Numri i studentëve të programit TOBMSH, ka qenë i kufizuar dhe si tillë nuk ka paraqitur vështirësi në akomodim si në klasa ashtu dhe në laboratore dhe praktikë mësimore. <i>(Raporti ekspertit për infrastrukturën, Dokumenti 42.a)</i>			
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.	Në Strategjinë e Zhvillimit të UniBa 2020-2030, një nga objektivat strategjike është ai i universitetit digjital për këtë arsye në kampusin e ri auditorët janë atrecuar me mjetet audio dhe videot e smartboard-e. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion evidentuam që në kampus janë disa laboratore IT, të cilat akomodojnë mjaft mirë dhe nevojat e studentëve, si dhe zyra komode dhe me të gjitha pajisjet e domosdoshme. <i>(Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030, Dokumenti 3)</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për mënyrën si funksion Grupi Barleti, vecanërisht në rastin e programit mësimor Diplomë Profesionale në TOBMSH, mbështet përmes Vitamina HUB dhe Departamentit të Marketingut të grupit, pjesën aplikative të disa lëndëve dhe të praktikave. Në lidhje me pjesën hardëare, kampusi (auditore, laboratore) dhe ambientet e qendrave janë mirë të atrecuara me pajisjet e duhura për të përmbushur objektivat e programeve të lëndëve dhe të programit të studimit. <i>Dokumenti 42.a: Raporti ekspertit për infrastrukturën,</i> <i>Dokumenti 4: Plani i Zhvillimit të Programit</i>			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Institucioni zotëron 4 (katër) laboratorë të teknologjisë së informacionit, nisur nga numrat e studentëve të regjistruar janë mëse të mjaftueshëm për akomodimin e tyre. Gjithashtu, në lidhje me programet kompjuterike dhe pajisje specifike që programi studimit diplomë profesionale në TOBMSH kërkon një mbështetje jep dhe Departamenti i Marketingut të Grupit Barleti dhe Vitamina HUB, të cilën e evidentuam dhe gjatë vizitës në institucion.			

	<i>Dokumenti 42.a: Raporti ekspertit për infrastrukturën</i> <i>Dokumenti 27: Të dhëna për rregjistrimin e studentëve</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	UniBA aktualisht ka mjediset e duhura për realizimin procesit mësimor, ndërkohë që në dispozicion të këtij programi studimi janë dhe mjediset e bizneseve të Grupit Barleti. <i>Në lidhje me bashkëpunimet me organizatat/institucionet e tjera, do të sugjerohet që do ishte më frytdhënëse që studentët të bënin praktika dhe intershipe në biznese më pranë profilit të tyre të studimit, nisur dhe nga informacioni i dhënë në e-ascal dhe nga vizita në insitucion</i> <i>Dokumenti 32: Tabela përmbledhëse: Intitucionet e bashkëpunimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	UniBa tashmë ka përqëndruar të gjithë procesin mësimor në kampusin e ri, ku biblioteka ndodhet në katin e parë, pranë dhe Triple City dhe disa ambjenteve të tjera rekreative, poste leximi, poste me kompjutera për të naviguar në bibliotekat digjitale, rafta me libra dhe revista. Gjatë vizitës në UniBA, personi përgjegjës për bibliotekën shpjegoi konceptin që kanë drejtuesit e institucionit për të pasur bibliotekën në disa ambjente, me qëllim që libri të shkojë më pranë studentit. Kjo është arsyeja që brenda kampusit të ri janë dy hapësira kushtuar librit, leximit dhe aksesimit të materialeve online. <i>Dokumenti 42 c. Të dhëna mbi bibliotekën</i> <i>Dokumenti 42 d. Të dhëna për platformat online</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka rreth 36 tituj librash që konsiderohen në funksion të programit të studimit diplomë profesionale TOBMSH, por jo të gjitha i përkasin këtij programi studimi. <i>Në lidhje me tekstet fizike që ndodhen në bibliotekë për programin e studimit TOBMSH, por dhe për tekstet që janë në silabuset e lëndëve sugjerojmë që duhen përditësuar. Janë një sërë botimesh dhe në gjuhën shqipe të teksteve të Pearson. Përditësimi i literaturës do të bënte lëndët dhe programin më tërheqës, dhe studentët do të pajiseshin me njohuritë dhe aftësitë që kërkon tregu i punës.</i>



	<i>Dokumenti 45. Lista e teksteve për programin TOBMSH.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Brenda ambjenteve të universitetit studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë bibliotekat online. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik disa platforma të cilat janë mundësuar përmes projekteve dhe që japin një gamë të gjerë titujsh, artikujsh, dizertacionesh etj.</p> <p>Platformat online të përdorura janë: JSTOR – mund të aksesosh më shumë se 12 milion artikuj, libra etj; Open Dissertation.org – përmban disertacione nga viti 1995 deri tani; DOAJ – akses në revista.</p> <p><i>Dokumenti 42 d. Të dhëna për platformat online</i></p> <p><i>Dokumenti 42 c. Të dhëna mbi bibliotekën</i></p>
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	<p>Në tabelën përmbledhëse “Institucionet e bashkëpunimit” evidentohet që ka një numër marrëveshjes instrucionale, të cilat më tepër se për programin diplomë profesionale në TOBMSH janë për të gjithë Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.</p> <p>Praktika e studentëve është konceptuar brenda Planit mësimor të zhvillohet në çdo semester. Bazuar në “Raportin e përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit” studentët janë akomoduar gjatë vitit 2020-2021 në: Credins Bank; Concept Marketing Albania dhe kanë bërë një vizitë në Agna Group. Natyrisht, periudha e pandemisë ka vendosur kufizimet e veta, por numri i kufizuar i studentëve ka lehtësuar bashkëpunimin me organizatat.</p> <p>Sugjerojmë që institucioni, të ndëtojë një qasje më proaktive në lidhje me praktikën mësimore, qoftë në drejtim të organizatave ku akomodohen studentët ashtu dhe në drejtim të “output-it” të tyre. Gjithashtu, të hartohet dhe një marrëveshje tip për lidhjet me institucionet dhe kompanitë e biznesit, veçanërisht kjo e fundit e rëndësishme për programin e studimit diplomë profesionale TOBMSH.</p> <p><i>Dokumenti 32. Tabela përmbledhëse: Institucionet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 14 a. Plani mësimor MST</i></p> <p><i>Dokumenti 35. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	<p>UniBa bazuar në “Të dhëna nga Plani i financimit të Programit të Studimit” për periudhën 2018-2020 të ardhurat vijnë përmes disa burimeve: tarifat e studimit; nga konsulencat dhe shërbimet; shërbimi trajnimi dhe të tjera. Kosto për student është 1245 Euro</p> <p>Raporti financiar vjetor institucional, bën një analizë të sektorit të arsimit të lartë, të ecurisë së universitetit nga pikëpamja programeve, punësimit dhe rekrutimit të studentëve. Gjithashtu, paraqitet pasqyra e të ardhurave-shpënzimeve, fitimi i institucionit dhe bëhet parashkimi për dy vitet e ardhshme. Në Raport duket që institucioni është rritur dhe ka një situatë</p>

	<p>financiare të shëndetshme.</p> <p><i>Dokumenti 50: Të dhëna nga Plani i financimit të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 49: Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional</i></p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>UniBA në vitet e fundit, krahas investimit të bërë në një kampus të ri universitar, një strukturë moderne nga pikëpamja e ndërtimit, është fokusuar në zhvillimin e institucionit duke e konceptuar dhe orientuar universitetin si sipërmarrës, inovativ, digjital.</p> <p>Gjithashtu, raportet financiare tregojnë që burimet e financimit të universitetit janë të diversifikuara, kjo dhe për shkak të qasjes përmes qendrave dhe institutive që Grupi Barleti ka ngritur.</p> <p>Raportet financiare të viteve të shkuara reflektojnë rritje të institucionit nga pikëpamja e të ardhurave, si dhe një qëndrueshmëri përsa i përket marzhit të fitimit.</p> <p><i>Dokumenti 3: Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030</i></p> <p><i>Dokumenti 49: Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional</i></p> <p><i>Dokumenti 50: Të dhëna nga Plani i financimit të Programit të Studimit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Funksionimi i UniBA në të gjitha raportet e brendshme dhe të jashtme, bazohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015 - VKM nr 879, datë 18.12.2019; - Statutin e Universitet “Marin Barleti” - Rregulloren Akademike <p>Mbi këtë bazë është hartuar Rregullorja e Fakultetit dhe Rregullorja e Programit Diplomë Profesionale, në të cilën qartësohen të gjitha marrëdhëniet dhe proceset me studentët, që nga pranimi, frekuentimi, vlerësimi, kohëzgjatja e studimeve, kontrata e studimeve, pjesa financiare etj.</p> <p>Në UniBA ka një fokus të qartë në ngritjen e një marrëdhënie të qëndrueshme me studentët që nga momenti që hyn për të marrë informacion në Zyrën e Pranimit, vijon më pas me Dekanen e Studentëve dhe përfundon me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit. Në</p>

	<p>nivelin më të lartë të strukturës drejtuese të universitetit ka një zvrektoer i cili i dedikua për çështjet studentore</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti IAL</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 53: Ligji për Arsimin e Lartë, Nr 80/2015</i></p> <p><i>Dokumenti 55: VKM nr 879, datë 18.12.2019</i></p> <p><i>Dokumenti 6.a. Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit Profesional</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Pranimi i studentëve mbështetet në aktet ligjore dhe udhëzimet që nxjerr MAS dhe që përditësohen vit pas viti. Në kushtet e një universiteti privat, procesi i rekrutimit të studentëve të rinj, përfshirë dhe studentët e TOBMSH, mbështetet në këto udhëzime të ministrisë, në rregullat e Maturës Shtetërore, në Manualin Rekrutim-Aplikim-Rregjistrim-Transferim dhe një sërë vendimesh që merren në senatin e UniBA.</p> <p>Vendimet e senatit të universitetit në lidhje me kriteret e pranimit i bëhen të ditura ministrisë, publikohen në portalin e Maturës U-Albania si dhe në website e UniBA prej nga mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Për pranimin e studentëve në diplomë profesionale në TOBMSH, kriteret e pranimit janë ato të përcaktuara nga VKM për vitin përkatës. Bazuar në Vendimin e senatit për kriteret e pranimit, për dy studentë që kanë mesatare të njëjtë diferencimi bëhet nga nota e provimit të matematikës.</p> <p><i>Dokumenti 62: Manuali Rekrutim- Aplikim- Rregjistrim-Transferim.</i></p> <p><i>Dokumenti 63: Udhëzim Nr 54, datë9.01.2019 për rekrutimet 2019-2020;</i></p> <p><i>Dokumenti 64: Vendim senati: Kriteret e pranimit të studentëve në vitin 2020-2021;</i></p> <p><i>Dokumenti 65: Rregullore për transferimin dhe rregjistrimin në programet e dyta.</i></p> <p><i>Dokumenti 12. Rregullore e funksionimit të Zyrave në shërbim të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Institucioni i vë në dispozicion studentit Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit TOBMSH.</p> <p>Në kreun V të Rregullores së Universitetit jepet “Organizimi i studimeve në Universitetin Barleti” ku gjendet i gjithë informacioni në lidhje me kohën e studimit, numrin e krediteve që duhet të ketë fituar studenti për të kaluar në vitin pasardhës, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve; vitin akademik dhe semestrat, procesin mësimor, orën mësimore, lëndët dhe modulet mësimore; kreditet, frekuentimin, Në kreun VI të Rregullores së</p>

	<p>Universitetit jepet të gjitha nenet që kanë të bëjnë me pranimin dhe regjistrimin e studentëve, në kreun VII – Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijes, jepet informacioni mbi sistemin e vlerësimit, kontrollin e dijes, provimin ndërmjetës e përfundimtar; ankimimin për vlerësimin e provimit, sezonet dhe riprovimet, praktikant dhe dhe Kreun VIII -përfundimin e studimeve</p> <p>Rregullorja e programit të studimit, mbështetet në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr 80/2015; Statutin e UniBA, Rregulloren e universitetit dhe akte të tjera të UniBA. Në këtë rregullore, student gjen të gjithë rregullat në ndjekjen e këtij programi studimi.</p> <p>Studentët informohen mbi rregullat e UniBA, në javën e akomodimit, por dhe përmes koordinatores së programit, sekretarisë mësimore dhe pedagogëve.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 6.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Marrëdhënien me studentët institucioni e ka konceptuar dhe ngritur në nivel zvrrektori për çështjet studentore, në varësinë e të cilit janë: Zyra e Pranimin dhe Rekrutimit të Studentëve, Dekania e Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>UniBA përmes ditëve të pritjes e orientimit të maturantëve në institucion, në gjimnaze e ambiente të tjera të përcaktuara nga Drejtoritë Arsimore bën informimin e maturantëve për programet e studimit, përfshirë këtë dhe programin TOBMSH.</p> <p><i>Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi, është një tregues që duhen gjetur kanalë më efikase të komunikimit me maturantët, ndërkohë që duhet eksploruar mundësia e targetimit të individëve që janë në tregun e punës, punojnë në këto pozicioneve por që nuk kanë formimin e duhur në këtë drejtim. Kjo do të kërkonte një raport më të ngushtë me tregun e punës, me kompanitë shqiptare që kanë mjaftueshëm operacione biznesi, marketing dhe shitje.</i></p> <p>Në hollin e universitetit gjenden material informuese si fletëpalosje, broshura dhe material video. Në faqen dedikuar departamentin nga ku buron programi në internet gjendet informacioni për programin TOBMSH.</p> <p>Dekania e studentëve përmes bashkëpunimit me departamentet dhe pedagogët organizon aktivitete të natyrave të ndryshme si dhe përcakton një plan të aktiviteteve vjetore. Gjatë vizitës në institucion, Dekania e studentëve, tregoi planin vjetor të aktiviteteve, por ne platform nuk është depozituar.</p> <p>Njësisia tjetër është Zyra e Karrierës e cila ka nënshkruar një numër marrëveshjes me tregun e punës, por siç kemi theksuar dhe në rubrikat më lart ato janë më shumë në shërbim të</p>

	<p>programeve të tjera të Departamentit dhe Fakultetit.</p> <p>Departamenti ka ngritur dhe Bordin e Karrierës, por mbetet pak i paqartë qëllimi i tij, përbërja nga pikëpamja e cilësië së personave që ndodhen në të dhe plani i aktiviteteve të Departamentit me ta.</p> <p><i>Dokumenti 32. Tabelë përmbledhëse e institucioneve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 38.c: Vendim Departamenti për krijimin e Bordit të Karrierës në Departamentin e Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe financës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë javës së akomodimit në universitet studentët marrin nëpërmjet Dekanit, shefit të departamentit dhe strukturave të studentit gjithë mbështetjen e duhur në raport me programin e studimit, rregullat dhe procedurat e institucionit, modulet dhe lëndët. Gjithashtu, çdo pedagog në fillim të semestrit dhe mësimdhënies në lëndën e tij, në përputhje me Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit dhe të Silabusit informon dhe qartëson studentët në lidhje me përmbajtjen e lëndës, frekuentimin e saj, format e kontrollit të dijes, literaturën, llojin e detyrave e laboratoreve.</p> <p>Në funksion të mbështetjes së vazhdueshme të studentëve janë koordinatori i Departamentit dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p>Programi i studimit që akreditohet për herë të parë në TOBMSH, ka zhvilluar mësimin kryesisht online në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të pandemisë. Për këtë arsye, institucioni ka ngritur gjithë infrastrukturën e duhur për realizimin e mësimin online, përmes platformës Google Classroom. Për t'u ardhur në ndihmë studentëve dhe stafit është hartuar Manuali i Mësimdhënies Online.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 6.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 19: Silabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 39: Manual i Mësimdhënies Online</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të universitetit, gjendet gjithë informacioni për programin e studimit. Gjithashtu në UniBa, nisur dhe nga synimet e tij për t'u kthyer në një universitet digjital janë vënë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik një numër platformash.</p> <p>Portali Studentor u jep mundësinë studentëve që në kohë reale të aksesojnë të dhënat për të cilat kanë nevojë të informohen: pedagogët, lëndët, rezultatet e tyre etj.</p> <p><i>Dokumenti 48.b: Manuali i përdorimit të Portalit Studentor:</i></p> <p><i>Dokumenti 48.c.2. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët</i></p>

	<i>Dokumenti 48.f1: Manuali i përdorimit të SISclaster për studentët</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>UniBA në sfidën strategjike të tij të një universiteti digjital, ka ngritur dhe funksion bazuar në disa sisteme të menaxhimit të sistemit të të dhënave. Kështu, nga web i universitetit studentët mund të aksesojnë Portalin Studentor – ku studentët gjejnë informacionin mbi sistemin e të dhënave që menaxhon sekretaria, orarin dhe të dhëna të tjera.</p> <p>Programi TOBMSH po kalon procesin e vlerësimit të jashtëm për periudhën që universiteti ka zhvilluar veprimtarinë e tij kryesisht online. Në funksion të mësimin online universiteti ka hartuar dy manuale, për studentët dhe pedagogët për të mbështetur procesin mësimor të realizuar përmes platformës Google Classroom.</p> <p><i>Universiteti ende nuk ka një platformë të mirëfilltë Learning Management Sistem, që do të integronte mësimdhënien me ecurinë akademike, dhe do lehtësonte studentët që të kishin online të gjithë informacionin nga silabuset, materialet e pedagogut, literaturën bazë dhe të rekomanduar, si dhe të krijonte një ndërveprim për detyrat e projektet, dhe vlerësimin. Gjatë vizitës në institucion u evidentua që sekretaria mësimore punon ende përmes Microsoft Excel.</i></p> <p><i>Dokumenti 3: Strategjia e zhvillimit institucional</i></p> <p><i>Dokumenti 48.b: Manuali i përdorimit të portalit studentor</i></p> <p><i>Dokumenti 48 c1: Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i></p> <p><i>Dokumenti 48 c2: Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Universiteti ka intranetin për komunikimin e brendshëm. Çdo person që bëhet pjesë e UniBA (staf i brendshëm akademik, student, staf administrative dhe staf akademik me kohë të pjesshme) pajiset me kredencialet e tij dhe adresën e email në domenin @umb.edu.al. Përdorimi dhe integrimi i informacionit të departamenteve, zyrave dhe pedagogëve në intranet bëhet përmes mbështetjes së Udhëzuesit për përdorimin e strukturës së teknologjisë dhe manualit të përdorimit të intranetit. Një rëndësi</p>

	<p>i kushtohet ruajtjes së privatësisë së informacionit, për këtë qëllim institucioni ka përcaktuar Politikat e Privatësisë së UniBa.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i GSuite mundëson komunikimin përmes email të UniBA, duke bërë të mundur ndarjen e materialeve mes kolegeve me Google Drive, Google docs etj.</p> <p>Për komunikimin e jashtëm përdor web dhe median sociale, publikimet në të cilat janë konceptuar dhe realizohen përmes disa procedurave dhe standardeve.</p> <p>Për periudhën për të cilën vlerësohet programi Diplomë Profesionale “Teknik Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” mësimi është zhvilluar kryesisht online. Brenda platformës Google Classroom studentët kanë gjetur gjithë informacionin e duhur për lëndët, leksionet e pedagogut, silabusin dhe material të tjera në funksion të mësimdhënies.</p> <p>Ndërkohë pedagogët, koordinatori i programit dhe zyra të veçanta që kanë ndërveprim me studentin, kanë komunikuar dhe përmes adresave zyrtare të email.</p> <p><i>Dokumenti 46: Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.</i></p> <p><i>Dokumenti 48.e: Manuali i përdorimit të intranetit</i></p> <p><i>Dokumenti 48.g: Politikat e Privatësisë së Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 48.d: Manuali i përdorimit të GSuite</i></p> <p><i>Dokumenti 48.h1: Procedurat dhe standardet për publikimet në rrjetet sociale</i></p> <p><i>Dokumenti 48.h2: Procedurat dhe standardet për publikimet në web</i></p> <p><i>Dokumenti 48 c1: Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i></p> <p><i>Dokumenti 48 c2: Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p><i>Learning Management System mungon në UniBA, siç mungon dhe sistemi i menaxhimit të dhënave të sekretarisë mësimore.</i></p> <p>Duhet thënë që për periudhën për të cilin programi profesional në TOBMSH vlerësohet, mësimi është kryer kryesisht online dhe në platformën Google Classroom studentët përveç mësimin online, kanë gjetur të depozituar leksionet, silabuset dhe materiale të tjera.</p> <p><i>Dokumenti 48 c1: Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i></p> <p><i>Dokumenti 48 c2: Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të</p>	<p>Mungesa e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit besojmë se vendos disa kufizime në monitorimin</p>

aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Gjithashtu, besojmë që dhe nga pikëpamja e interface me Portalin Studentor, sistemi i integruar do të mundësonte që procesimi të ishte në kohë reale.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen e internetit të UniBA informacioni jepet në gjuhën shqiptare dhe angleze. Nga faqja e internetit studentët dhe të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin në lidhje me universitetin, strukturën e tij, dokumentacionin ligjor, aktivitetet, programet dhe gjithë aktivitetet e ndryshme që zhvillon së bashku me qendrat dhe institutet. Gjithashtu në të studentët mund të gjejnë informacione mbi pranimin në universitet, aktivitetet studentore, qeverinë studentore, Zyrën e karrierës, broshurat e universitetit dhe përmes web mund të aksesojnë Platformën Studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti Barleti ka ngritur një strukturë efikase në funksion të studentit, që punon me të, e informon, kujdeset dhe e drejton në karrierën pasi përfundon studimet. Struktura që fokusohet tek studentit drejtohet nga zv/Rektori për Çështjet Studentore, në varësi të tij janë: Zyra e Pranimit dhe Rekrutimit; Dekani i Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit. Veprimtaria e këtyre Zyrave dhe njërive bazohet në Statutin e Universitetit, një sërë rregulloresh dhe përcaktohet nga Rregullorja e Funksionimit të Zyrave në Shërbimtë Studentëve</p> <p>Secila nga zyrat ka qëllim, detyra dhe përgjegjësi të qarta e të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit dhe në Rregulloren e Funksionimit të Zyrave në Shërbimtë Studentëve dhe gjatë vizitës në universitet u shprehën që kanë dhe një plan pune.</p> <p>Në Strategjinë e Marketingut dhe Rekrutimit, paraqiten elementë të rëndësishëm të analizës së markës dhe të marketingut, ku bëjmë pjesë dhe taktikat e plani veprimi që lidhet me rekrutimin, jetën studentore, etj.</p> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit diplomë profesionale TOBMSH, studentët gjejnë të gjithë informacionin mbi programin, organizimin e tij. Në mbështetje të studentëve janë zyrat e studentëve dhe koordinatori i programit.</p> <p>Në funksion të veprimtarisë së Zyrës së Pranimit dhe Rekrutimit është dhe Manuali Rekrutim-Aplikim- Rregjistrim dhe Transferim i Studentëve, i cili vlen për përdorim të brendshëm strukturën dhe definon detyrat, por qartëson dhe mënyrën si procedohet në përputhje me udhëzimet e MAS.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 51: Strategjia e Marketingut dhe Rekrutimit</i></p> <p><i>Dokumenti 6.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7. Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 12: Rregullore e Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Manuali Rekrutim-Aplikim- Rregjistrim dhe Transferim i Studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>UniBA në lidhje me kriteret e aplikuar për pranimet në programin e studimit TOBMSH, nuk aplikon kriteret shtesë mbi ato të deklaruara nga aktet ligjore dhe nënligjore.</p>

<p>kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UniBa vendos në shërbim të interesuarve informacion në lidhje me kriteret e pranimit, të cilat publikohen në faqen në ËEB.</p> <p>Kriteret e pranimit në programin profesional TOBMSH pasqyrohen dhe në Kreun 5, Neni 26 të Rregullores së Programit Profesional Teknik Operacionesh Biznesi, Marketingu dhe Shitje.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, studentët konfirmuan që një pjesë e tyre janë trajtuar me bursa. UniBa ka disa kategori bursash: ekselente, sociale, të talentit dhe të lidërsipit.</p> <p><i>Dokumenti 64: Vendim Senati: Kriteret e pranimit të studentëve në vitin akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e Programit Profesional TOBMSH</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik, gjatë organizimit të javës së akomodimit të studentëve, Departamenti, pedagogët dhe Zyrat në Shërbim të Studentëve qartësojnë çështjet që lidhen me Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Programit të Studimit TOBMSH.</p> <p>Në Rregulloren e Programit Profesional janë parashikuar procedura në lidhje me ecurinë akademike të studentit, dokumentimin e vlerësimit, komunikimi i vlerësimeve, e drejta për të hyrë në provim, ndërpreja e studimeve, transferimi i studimeve, etj</p> <p>Në mbështetje të qartësimit të procedurave të ndryshme janë dhe koordinatorja e programit, sekretaria mësimore dhe pedagogët për gjithshka që lidhet me lëndën: frekuentim/detyrime/vlerësime dhe përmbajtje/literaturë.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e Programit Profesional TOBMSH</i></p> <p><i>Dokumenti 65: Rregullore për transferimin dhe rregjistrimin në programet e dyta</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Manuali Rekrutim-Aplikim- Rregjistrim dhe Transferim i Studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në kreun III të Rregullores së Programit Profesional TOBMSH janë përcaktuar kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu, format e vlerësimit të dijeve janë përcaktuar dhe në silabuset e lëndëve/moduleve dhe u bëhen të njohura studentëve.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, evidentuam që në lëndë të caktuara provimi ishte zhvilluar me gojë (formë që rregullorja e lejon), por nuk na u qartësua plotësisht procedura e provimit me gojë. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët ata u shprehën se nuk realizohet seanca pas provimit ku studenti mund të kërkojë të shohë vlerësimin dhe të kërkojë shpjegim dhe qartësim të pikëve të vëna nga ana e pedagogut. Në pikëpamje të formimit të tyre studentët u shprehën se ndiejnë nevojën e më shumë aftësimi praktik dhe praktika të organizohet në kompani të ndryshme.</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e Programit Profesional TOBMSH</i></p>

	<i>Dokumenti 19.I. Silabuset e lëndëve</i>			
	<i>Dokumenti 19. II. Silabuset e lëndëve</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Në përputhje me Strategjinë e Marketingut dhe Manualin Rekrutim- Aplikim- Rregjistrim dhe Transferim i Studentëve, Zyrat përgjegjëse për studentët në bashkëpunim me departamentet organizojnë orë të hapura në UniBa me maturantët, vizita në shkollat e mesme.</p> <p>Natyrisht, në web i universitetit maturantët dhe të interesuarit gjejnë të gjithë informacionin në lidhje me kriteret e pranimit. Gjithashtu, Zyra e Pranimit dhe Rekrutimit u transmeton të gjithë informacionin të interesuarve që vijnë në kampus.</p> <p>Një mënyrë e përdorur gjerësisht në dy vitet e fundit, është dhe ai i takimeve online me maturantët.</p> <p><i>Dokumenti 51: Strategjia e Marketingut dhe Rekrutimit</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Manuali Rekrutim-Aplikim- Rregjistrim dhe Transferim i Studentëve</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	<p>Në mjediset e UniBa, studentët dhe të interesuarit gjejnë të ekspozuar në holl dhe në mjedise të tjera të përbashkta materiale informuese, si fletëpalosje, broshurën e universitetit, postera, spote, material promovuese audio-vizive.</p> <p>Zyra e Pranimit dhe Rekrutimit, Dekania e Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Alumnit pret dhe informon çdo person të interesuar për të studjuar në UniBA, në këtë program studimi dhe në çdo program tjetër.</p> <p>Në përputhje me Strategjinë e Marketingut dhe Rekrutimit të UniBA gjatë ditëve të aktiviteteve me maturantët dhe gjatë ditëve të rregjistrimit, drejtuesit e fakultetit dhe departamentit kane një qasje proaktive dhe shumë ndërvepruese, për të gjithë programet e studimit, programin TOBMSH përfshirë.</p> <p>Ndërkohë një rol të rëndësishëm në lidhje me këshillimin për strukturën e programit, kohëzgjatjen, përmbajtjen luan dhe koordinatori i programit.</p> <p>Gjithashtu, në orën e parë të mësimit, pedagogu i lëndës qartëson me studentët përmbajtjen e silabusit, objektivat e studimit të lëndës, literaturën bazë dhe të rekomanduar, frekuentimin dhe</p>

	<p>format e vlerësimit.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, me drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, si dhe me personat përgjegjës për rekrutimet u përpoqëm të diskutonim dilemat e programit që reflektohen dhe në numrin e kufizuar të studentëve në programin profesional. Duket që ka një diskrecion midis asaj që u ndodh dhe mënyrës se si duan ta ndryshojnë, tregut që duhet t'i shërbejnë dhe segmentit të studentëve që dëshirojnë të arrijnë.</i></p> <p><i>Dokumenti 51: Strategjia e Marketingut dhe Rekrutimit</i></p> <p><i>Dokumenti 19. Silabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 27: Të dhëna mbi rregjistrimin e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p><i>Gjatë takimit në institucion studentët u shprehën që nevojitet më shumë aftësim, më shumë praktikë dhe në organizata më afër formimit që tregu kërkon për ta.</i></p> <p>UniBA ka një numër marrëveshjes bashkëpunimi me organizata publike dhe kompani biznesi, por siç shihet dhe nga Tabela përmbledhëse <i>një pjesë e këtyre organizatave nuk janë të përshtatshme për këtë program studimi.</i></p> <p>Grupi Barleti, mund të jetë një mbështetje më e fuqishme për zhvillimin e praktikave, por mbetet për t'u riparë në momentin që do shikohet programi dhe plani mësimor dhe mënyra e zhvillimit të praktikës. <i>Ka paqartësi në planin mësimor, por kjo u evidentua dhe gjatë vizitës në institucion për mënyrën se si kreditet e praktikës organizohen. Praktika në planin mësimor rezulton të jetë dhe në kategorinë D dhe E.</i></p> <p>UniBA përmes Vendimit të Senatit ka miratuar Paketën e Praktikës, e cila përmban procedurën dhe formularët që duhen plotësuar.</p> <p>Departamenti Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, ka krijuar Bordin e Karrierës. Qëllimet duken pozitive, por <i>mbetet e paqartë çfarë përfaqësojnë anëtarët e bordit dhe çfarë veprimtarish janë kryer me ta.</i></p> <p>Zyrat e Alumnit dhe Karrierës është një urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës, por <i>mbetet ende shumë për të vënë në dinamikën e duhur këtë proces.</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe praktikën profesionale</i></p> <p><i>Dokumenti 14. Plani mësimor</i></p> <p><i>Dokumenti 32.b. Vendimi i senatit Nr. 29, datë 23.10.2019</i></p> <p><i>Dokumenti 32.a. Paketa e Praktikës</i></p> <p><i>Dokumenti 38.c. Vendim Departamenti për Krijimin e Bordit të Karrierës</i></p>

<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Koordinatori i programit ka një rol të rendësishëm në vënien në dispozicion të studentëve të informacioneve dhe dinamikave që shoqërojnë procesin mësimor.</p> <p>Përmes sistemit të email me domen @uba.edu.al koordinatori i programit informon në mënyrë vazhdueshme studentët për çdo ndryshim, orare, auditore, aktivitete, etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët e programit profesional TOBMSH, kanë zhvilluar mësim kryesisht online, pasi periudha për të cilën bëhet vlerësimi përmes këtij raporti përputhet me situatën e pandemisë Covid 19. Mësimi është zhvilluar nëpërmjet platformës Google Clsrrrom, ku studentët kanë gjetur të depozituar çdo informacion të nevojshëm për ecurinë e tyre.</p> <p>Portali Studentor i UniBA është i aksesueshëm nga web i universitetit, duke i mundësuar studentëve informacion mbi programin e studimit, dhe ecurinë e tyre.</p> <p>UniBa nuk ka një sistem të integruar Learning Management Sistem, ku studentët të kishin mundësi të gjenin dhe materialet e mësimi, literaturën etj.</p> <p><i>Dokumenti 48.a: Manuali i përdorimit të portalit studentor</i></p> <p><i>Dokumenti 48.c2: Manuali i përdorimit të platformës Google Classroom për Studentët</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit profesional në TOBMSH kalon në procesin e vlerësimit të jashtëm për akreditim për herë të parë, statistikat e grumbulluara dhe të përpunuara nga institucioni ekzistojnë, por për shkak të numrit të vogël të studentëve të dhënat që rezultojë nuk përbëjnë një kampion nga e cili mund të gjykohet më tej.</p> <p><i>Dokumenti 27: Të dhëna mbi nr e studentëve të rregjistruar</i></p> <p><i>Dokumenti 28: Të dhëna mbi nr e studentëve të diplomuar dhe punësuar</i></p> <p><i>Dokumenti 29: Të dhëna mbi nota mesatare në hyrje</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para</p>	<p>UniBA disponon dhe ruan statistikat vjetore, por siç kemi evidentuar në këtë raport, në këtë program janë regjistruar gjithsej 18 studentë.</p>

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vitin 2018-2019 – rregjistruar 4 studentë. Në vitin 2019-2020 – rregjistruar 11 studentë. Në vitin 2020-2021 – rregjistruar 4 studentë.</p> <p>Gjithsej janë diplomuar 4 studentë. Ky numër dëshmon për dropout të lartë në system, nëse do të gjykonim në përqindje vetëm 26% janë diplomuar.</p> <p><i>Dokumenti 27: Të dhëna mbi nr e studentëve të rregjistruar</i> <i>Dokumenti 28: Të dhëna mbi nr e studentëve të diplomuar dhe punësuar</i> <i>Dokumenti 29: Të dhëna mbi nota mesatare në hyrje</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>UniBA disponon të dhënat e plota mbi ecurinë e studentit. Gjatë vizitës në institucion evidentuam që process verbalet e provimeve dhe rregjistri i të dhënave ishin mbajtur me kujdes.</p> <p><i>Sekretaria nuk punon me sistem të menaxhimit të të dhënave, gjithshka mbahet në excel. Gjithashtu, na rezultoi që çkodimi i provimeve bëhet nga vetë pedagogët dhe kjo do të duhet të rregullohet me qëllim që të ketë kuptim procesi sekretimit. Gjatë vizitës rezultoi që process verbali i komponentëve të vlerësimit të studentëve mbahet nga pedagogu në department, e njëta situatë dhe për tezat e provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve mbahen dhe përpunohen në excel, UniBA ende nuk ka ngritur një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit të sekretarisë.</p> <p>Natyrisht, informacioni i mbledhur dhe i përpunuar për vetë numrin e kufizuar të studentëve të programit TOBMSH është lehtësisht i menaxhueshëm dhe i verifikueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UniBA rezultoi që ndonëse studentët në hyrje, sic evidentohet dhe përmes statistikës së mesatare në hyrje, është e ulët një pjesë e studentëve kishin përmirësuar dukshëm notat dhe mesataren e tyre, e cila mendojmë që duhet analizuar, së bashku me dropout e lartë në këtë program.</p> <p>Departamenti bën një analizë vjetore, për rrjedhojë siç na rezultoi dhe gjatë vizitës drejtuesit janë të bindur për një sërë ndryshimesh që duhet ta shoqërojnë këtë program studimi për ta bërë të suksesshëm. Zyra e Alumnit dhe Karrierës në bashkëpunim me departamentin ofron mundësi të trajnimit dhe përgatitjes së studentëve për tregun e punës.</p> <p><i>Dokumenti 29: Të dhëna mbi nota mesatare në hyrje</i> <i>Dokumenti 38: Analiza e departamentit (vjetore/periodike) mbi arritjet e objektivave formuese dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional 2019-2020.</i> <i>Dokumenti 33: Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të studentëve të TOBMSH.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore në fuqi, Statutin e UniBA dhe Rregulloren e Universitetit, studentët gëzojnë të drejtën për t'u përfshirë në disa organe vendimmarrëse, ku ata angazhohen në këto procese dhe përfaqësojnë e mbrojnë interesat e studentëve, kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e institucionit.</p> <p>Studentët janë pjesë e disa strukturave si: Senati Akademik; Këshilli i Etikës dhe i Shanseve të Barabarta; Komisioni i Sgurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; Dekanati i Fakultetit; Mbledhjet e departamenteve 1 herë në muaj.</p> <p>Një organizim i rëndësishëm është dhe Qeveria Studentore e cila ndërvepron me strukturën akademike dhe përfaqëson e mbron të drejtat e studentëve dhe është organizatore e shumë aktiviteteve extracurriculare.</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 6.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 6.b: Rregullore e Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 13: Rregullore e KSBSC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Një aspekt i rëndësishëm i përfshirjes së studentëve në proceset e brendshme të vlerësimit të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pyetësori për studentët, i cili zhvillohet dy herë në vit duke vlerësuar procesin e mësimdhënies për çdo pedagog dhe lëndë, por dhe procese të tjera në universitet; - fokus grupet me studentët për të diskutuar dhe vlerësuar cilësinë e procese në universitet; - mbledhjet e departamenteve me studentë një herë në muaj; <p>Në këtë mënyrë, nga pikëpamja e rregulloreve dhe procedurave, institucioni ka ngritur sistemin që garanton përfshirjen e studentëve në proceset akademike.</p> <p><i>Dokumenti 40: Pyetësori i studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 40.a: Guida për fokus grupin</i></p> <p><i>Dokumenti 6.b: Rregullore e Departamentit</i></p>

	<i>Dokumenti 13: Rregullore e KSBSC</i>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit profesional TOBMSH në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore ka 120 ECTS, të cilat bazuar në Planin Mësimor ndahen në 30 ECTS për çdo semestër. Siç kemi theksuar dhe në vlerësimin e kritereve të tjera në këtë raport, praktika ndahet në çdo semestër nga 6 ECTS, por mbetet pak e paqartë mënyra e realizimit të saj.</p> <p>Koordinatori i departamentit, fasiliton proceset e brendshme, ai shërben si urë lidhëse mes departamentit/sekretarisë mësimore dhe studentëve.</p> <p>Në lidhje me të gjitha procedurat administrative që lidhen me procesin rekrutim, aplikim, regjistrim dhe transferim institucioni në shërbim të studentëve vihen strukturat e shërbimit ndaj studentëve, koordinatori departamentit, sekretaria mësimore të cilat funksionojnë bazuar në rregulloret e procedurat e brendshme.</p> <p><i>Dokumenti 14.a. Plani mësimor i Programit TOBMSH</i></p> <p><i>Dokumenti 36 b: Detyrat e koordinatorit të programit</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Manual Rekrutim- Aplikim- rregjistrim- Transferim</i></p> <p><i>Dokumenti 65: Rregullore e Brendshme për Transferimin dhe Rregjistrimin në Programe të Dyta</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrjes së tyre një herë në muaj në mbledhjet e departamentit; - Pyetësorët për studentët të cilët shërbejnë për të marrë informacion mbi lëndët dhe elementë të tjerë të programit të mësimit; - Fokus grupet, të cilat përmes metodologjisë që përdorin shërbejnë për përmirësimin dhe të programit. <p><i>Nga pikëpamja procedurale dokumentat ekzistojnë, por mendojmë që më e rëndësishme është krijimi i një kulture përfshirëse. Për më tepër, në këtë program studimi ndryshimet në përmbajtje të tij mund të bëhen vetëm pas procesit të akreditimit, ndërkohë që në silabusin e lëndëve siç kemi thënë ka shumë hapësirë për përmirësim.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.b: Rregullore e Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 40: Pyetësori i studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 40..a: Guida për fokus grupin</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijes ndonëse qartësohet në Rregulloren e Universitetit dhe si rregull dhe në Silabuset e lëndëve, gjatë vizitës në institucion konstatuam që mënyra e vlerësimit mund të ishte me gojë ose me shkrim për provimin përfundimtar, por e pa cilësuar kështu në silabus.</p>



rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Gjithashtu, po gjatë vizitës rezultoi që seanca e ankimimit, rishikimit mbi vlerësimin e detyrave/provimeve nuk zhvillohej, por ndoshta është një shmangie nga rregulloret dhe për shkak të numrit të vogël të studentëve dhe zhvillimit të mësimi kryesisht online. <i>Dokumenti 5: Rregullore e universitetit</i> <i>Dokumenti 19: Silabuset e lëndëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UniBa në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e universitetit, ka ngritur dhe vënë në funksion: Zyrën e Pranimit dhe Rekrutimit; Sekretarinë mësimore, Dekanin e Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës, koordinatoren e programit që përbën urën lidhëse administrative midis departamentit dhe studentëve. Universiteti funksionon duke vënë studentin në qendër, kjo reflektohet jo vetëm në ngritjen e strukturave që e mundësojnë atë, por dhe në komunikimin me studentët gjatë vizitës në institucion dhe stafin e zyrave në shërbim të studentit. Zyrat në shërbim të studentit mbajnë një ngarkesë të rëndësishme dhe japin një dinamikë të rëndësishme në universitetet private. <i>Dokumenti 2: Statuti IAL</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i> <i>Dokumenti 9: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Dokumenti 12: Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentit</i> <i>Dokumenti 36 a: Vendim për caktim koordinatori</i> <i>Dokumenti 36 b. Detyrat e koordinorit</i>
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Për gjithshka që lidhet me procesin mësimor studentët i drejtohen pedagogëve, koordinorit të programit dhe sekretarisë mësimore. Gjithashtu, përmes web të universitetit, Portalit Studentor dhe sistemit të email të intranetit departamenti, pedogogët, sekretaria mësimore, koordinatori i programit dhe zyrat në shërbim të studentit komunikojnë me studentët. Studenti në UniBa që nga momenti i hyrjes për të marrë informacion mbi programet e studimit dhe gjithë mënyrën si funksionon universiteti, në momentin e regjistrimit e më tej, në aktivitetete të ndryshme gjen mbështetjen e e Zyrës së Pranimit

	<p>e Rekrutimit, Dekanes së Studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 7: Rregullore e Programit profesional</i></p> <p><i>Dokumenti 9: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 36 a: Vendim për caktim koordinatori</i></p> <p><i>Dokumenti 36 b. Detyrat e koordinatorit</i></p> <p><i>Dokumenti 12: Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Mbështetja për jetën studentore gjatë kohës së qëndrimit në universitet të studentëve bëhet nga Dekania e Studentëve, e cila ka një plan të aktiviteteve extracurriculare që zhvillohen në institucion. Planin e aktiviteteve Dekania e Studentëve e paraqiti gjatë vizitës në UniBA.</p> <p>Një kontribut të rëndësishëm jep në konceptim dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, e cila ka iniciuar dhe një sërë trajnimesh me studentët.</p> <p>Përtej rregulloreve dhe përqasjes pozitive që gjetëm tek drejtueset e zyrave në shërbim të studentëve në kuptimin e funksionimit të klubeve studentore dhe aktiviteteve extracurriculare, duhet thënë që me studentët e programit TOBMSH duhet një qasje më përfshirëse dhe më drejtuese e orientuese e tyre drejt tregut të punës.</p> <p>Një avantazh i padiskutueshëm UniBA i vjen nga bizneset, qendrat dhe institutet e Grupit Barleti, ku studentët mund të zhvillojnë praktikën dhe periudha intershipi.</p> <p>Në lidhje me praktikën mësimore departamenti ka përcaktuar një pedagog përgjegjës për të ndjekur studentët në praktikë.</p> <p><i>Studentët gjatë takimit në institucion u shprehën për më shumë aftësim praktik dhe për zhvillimin e praktikës në institucione më afër programit TOBMSH</i></p> <p><i>Dokumenti 12: Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentit</i></p> <p><i>Dokumenti 33. Tabelë e trajnimeve profesionale</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 32.a.: Paketa e Praktikës</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Përtej rregulloreve dhe angazhimit të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit duhet theksuar që në programin TOBMSH janë diplomuar vetëm 4 studentë, 2 prej të cilëve janë punësuar.</p> <p><i>Sugjerohet që Zyrat e Shërbimit ndaj Studentit të përqendrohen më shumë në këshillimin dhe mbështetjen e studentëve dhe së bashku me koordinatoren e programit të lehtësojnë kapërcimin e vështirësive në system.</i></p> <p><i>Dokumenti 28: Të dhëna mbi nr e studentëve të diplomuar dhe punësuar</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura e Universitetit – Kampusi i ri i Universitetit “Barleti” është modern dhe i konceptuar e realizuar në përputhje dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2020-2030
2. Qendrat dhe Institutet pjesë e Grupit Barleti, mundësojnë një diversitet e energji inovative në universitet dhe në angazhimin e pedagogëve.
3. Hartimi i rregulloreve kryesore të institucionit, të cilat përbëjnë një bazë të mirë për të krijuar një kulturë në funksion të cilësisë.
4. Zyrat në Shërbim të Studentit

Pika të dobta:

1. Mungesa e një studimi tregu për këtë program studimi, reflektohet në konceptimin dhe strukturimin e programit, paqartësi në kompetencat që synojnë të krijojnë.
2. Kurrikula e ofruar paraqet problematikë të rëndësishme. Në programin mësimor mungon kategoria e lëndëve të formimit bazë (A), që përbëjnë 15-20% të krediteve. Gjithashtu evidentohen problematika në lëndët e ofruara, në emërtimin e tyre dhe përmbajtjen e tyre. Një pjesë e lëndëve nuk mund të ofrohen në një program profesional dy vjeçar, janë lëndë që zakonisht ofrohen në nivelet e tjera të studimit.
3. Përmbajtja e silabuseve, objektiva që tejkalojnë shpreh qëllimin e këtij programi dhe mundësitë e studentëve; përplasje në tema mes lëndëve; literaturë e vjetër në pjesën më të madhe të lëndëve;
4. Mungesa e Learning Management Sistem dhe e sistemit të menaxhimit të të dhenave të Sekretarisë Mësimore;
5. Qarkullim relativisht i lartë i stafit dhe i një pjese të stafit të Zyrave Administrative

Rekomandime:

1. Të rishikohet programi mësimor, të vendosen lëndë të formimit bazë Kategoria A, të rishikohen lëndët e kategorisë B; të rishikohen objektivat dhe të qartësohet cilat kompetenca programi TOBMSH kërkon të formojë; silabuset të shmangin përsëritjet dhe të përditësohet literatura; të ndryshohen emërtimet e lëndëve të caktuara: psh “Baza Marketingu dhe Konsumatori” të bëhet “Baza Marketingu”, në syllabus të thjeshtohen objektivat dhe lëndët të kenë emërtime më të shkurtra. Lënda “Puna në grup dhe komunikimi – Etika në punë dhe komunikimi” mund të konceptohet ndryshe. Dukshëm mungon një lëndë Bazat e Menaxhimit, në të cilën mund të përfshihet dhe Puna në ekip dhe Etika. Komunikimi dhe Komunikimi online mund të

bashkohen në një lëndë. Lënda “TIK në shkolla dhe shoqëri – Menaxhimi i proceseve të punës” nuk qëndron me këtë formulim për këtë program studimi; mundet që “Bazat e informatikës” do të ishte më afër programit TOBMSH. Lëndët “Bazat e programimit për marketing”, “Njohuri programimi për shitjet online” dhe “Marketingu digjital”, “Sisteme digjitale të shitjes” duhet të rishihen dhe riorganizohen.

2. Departamenti mund të konsiderojë në se e gjykon të arsyeshme rishpërndarjen e orëve dhe kreditëve në praktikën mësimore. Aktualisht praktika merr 3 forma përfshirje: si lëndë me 6 kredite, si pjesë e orëve të lëndëve/ moduleve të veçanta (15 orë) dhe si disiplinë më vete rubrika e detyrimeve përmbyllëse.
3. Pavarësisht strukturave që e kontrollojnë cilësinë e mësimdhënies, është e nevojshme hartimi i një dokumenti strategjik që orienton mësimdhënien.
4. Të përcaktohet drejt profili i studentëve që ndjekin këtë program duke bërë studimin në treg dhe mbi këtë bazë të ngrihet fushata e komunikimit dhe e marketingut.
5. Të ndërtohen marrëdhëniet e duhura me tregun e punës, duke u fokusuar më shumë në biznese dhe organizata që janë më pranë këtij programi studimi.
6. Të ngrihet sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit.
7. Të përmirësohen disa procedura në raport me çkodimin e provimeve, administrimin e komponentëve të vlerësimit dhe të provimeve nga sekretaria mësimore.

Conclusions of the Evaluation for the professional study program "Technician in Business Operations, Marketing and Sales" of the Higher Education Institution "Barleti University"

Strengths and affirmations:

1. University Infrastructure - The new campus of "Barleti University " is modern and conceived and realized following the Institution Development Strategy 2020-2030
2. Centers and Institutes part of the Barleti Group, enable diversity and innovative energy in the university and the engagement of professors.
3. Drafting the main regulations of the institution, which constitute a good basis for creating a culture in the function of quality.
4. Offices at Student Service

Weaknesses:

1. The lack of a market study for this study program is reflected in the conception and structuring of the curricula, and ambiguity in the competencies they intend to create.
2. The offered curricula present important issues. The curricula lacks the category of basic education subjects (A), which account for 15-20% of credits. Problems are also identified in the courses offered, in their naming and content. Part of the courses can not be offered in a two-year professional program, they are courses that are usually offered at other levels of study.
3. Content of syllabus, objectives that often exceed the purpose of this program and student opportunities; clashes in topics between subjects; old literature in most subjects;
4. Lack of Learning Management System and data management system of the Teaching Secretariat;
5. Relatively high turnover of staff and a part of the staff of the Administrative Offices

Recommendations:

1. To review the curricula, to establish basic education subjects, Category (A), to review the subjects of category B; to review the objectives and clarify which competencies the TOBMS program seeks to create; syllabus to avoid repetition and to update the literature; to change the names of certain subjects: for example "Basic of Marketing and Consumer " to become "Basics of Marketing", in the syllabus to simplify the objectives and the subjects to have shorter names. The course "Teamwork and communication - Ethics at work and communication" can be conceived differently. There is obviously a lack of a "Basics of Management" course, which may include Teamwork and Ethics. "Communication and Online Communication" can be combined into one subject. The course "ICT in schools and

society - Management of work processes" does not fit this study program; it is possible that the "Basics of Informatics" would be closer to the TOBMS program. The courses "Programming Basics for Marketing", "Programming Knowledge for Online Sales" and "Digital Marketing", "Digital Sales Systems" need to be reviewed and reorganized.

2. The Department may consider whether it deems reasonable the redistribution of hours and credits in teaching practice. Currently, the internship takes 3 forms: as a course with 6 credits, as part of the hours of special courses/modules (15 hours), and as a separate discipline "Rubric of Final Obligations".



3. Despite the structures that control the quality of teaching, it is necessary to draft a strategic document that guides teaching.

4. To correctly determine the profile of students who attend this program by doing market research and on this basis to set up a communication and marketing campaign.

5. Build the right relationships with the job market, focusing more on businesses and organizations that are closer to this study program.

6. Establish an integrated information management system

7. To improve some procedures related to the decoding of exams, and administration of the assessment components and exams by the Teaching Secretariat.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	